



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_. 11. 2009

**V E N D I M**  
**Nr. 1030 , datë 17. 11. 2009**

**Për**

**miratimin e dokumentit “Analize e Tregut te Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera, tregjet me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk te linjave me qera : Konsultim Publik”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- |                |        |         |
|----------------|--------|---------|
| 1. Z. Ilir     | Shehu  | Kryetar |
| 2. Z. Afrim    | Tonuzi | Anëtar  |
| 3. Znj. Edlira | Kasaj  | Anëtar  |
| 4. Z. Ilir     | Zela   | Anëtar  |
| 5. Z. Jetmir   | Karini | Anëtar  |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 17. 09. 2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike dhe Postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt:

**“Analize e Tregut te Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera, tregjet me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk te linjave me qera : Konsultim Publik”**

mori në shqyrtim materialet shkresore të përbëra nga:

- Relacioni
- Dokumenti i Analizes
- Projektvendimi

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 31, 32, 34, 35, 36 dhe neni 110 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 8485*), i ndryshuar;
3. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. “**Rregullore për analizën e tregut**” miratuar me VKD 747, date 17.07.2009.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E H E T se :

1. Dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit të Tregut për miratim për konsultim përbëhet nga:
  - Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485;
  - Dokumenti “**Analize e Tregut të Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit të linjave me qera, tregjet me shumice të segmenteve terminuese dhe trunk të linjave me qera : Konsultim Publik**”, përmban analizen për FNT të tregjeve nr.7, 12 dhe 13 të Rregullores për Analizën e Tregut, dhe detyrimet e propozuar për FNT në këto tregje.
  - Relacioni shpjegues për Projektvendimin e KD;

## PERFUNDIMISHT,

Këshilli Drejtues i AKEP, duke çmuar se:

1. Dokumenti “**Analize e Tregut të Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit të linjave me qera, tregjet me shumice të segmenteve terminuese dhe trunk të linjave me qera : Konsultim Publik**”, përmban analizen për FNT të tregjeve nr.7, 12 dhe 13 të Rregullores për Analizën e Tregut, dhe detyrimet e propozuar për FNT në këto tregje.
2. Versioni final i dokumentit për konsultim publik reflekton punën e Drejtorisë së Rregullimit Ekonomik si dhe komentet dhe vërejtjet e bera gjatë mbledhjes.

## ATEHERE:

Për sa më sipër si dhe duke patur parasysh se dokumenti: **“Analize e Tregut të Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit të linjave me qera, tregjet me shumice të segmenteve terminuese dhe trunk të linjave me qera : Konsultim Publik”** si një dokument rregullator shumë i rëndësishëm dhe me ndikim të ndjeshëm në tregun e komunikimeve elektronike, KD i AKEP bazuar në pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

#### **V E N D O S I :**

1. Miratimin për konsultim publik dhe publikim në faqen zyrtare të Internetit të AKEP të dokumentit **“Analize e Tregut të Linjave me Qera: Tregu me pakice i minimumit të linjave me qera, tregjet me shumice të segmenteve terminuese dhe trunk të linjave me qera : Konsultim Publik”** bashkangjitur këtij vendimi si Aneks I.
2. Procedura e konsultimit publik për dokumentin e analizës së tregut si dhe detyrimeve të propozuara për FNT, të cilat janë pjesë e dokumentit të analizës, të kryhet, nga data 23.11.2009 deri me 23.01.2010.
3. Të gjithë sipërmarrësit e autorizuar nga AKEP, që do të dërgohet njoftimi për dërgim të dhenash në AKEP, të depozitojnë në AKEP, informacionin e kërkuar sipas Aneks II të këtij vendimi, brenda datës 23.01.2010.
4. Të njoftohen palet e interesuara, përfshirë Autoritetin e Konkurrencës, për këtë vendim dhe publikimin e dokumentit, duke i ftuar për të dhënë komente.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES**

**Ilir SHEHU**

#### **Anëtarë të Këshillit Drejtues:**

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI

## Aneks II

Ne permbushje te detyrimeve te Ligjit Nr.9918, dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (Neni16), me qellim kryerjen e versionit final te **Analizes se tregut per linjat me qera**, ju kerkojme:

a) Te pershkruani infrastrukturen e rrjetit tuaj, kapacitetet transmetuese kombetare dhe nderkombetare dhe menyren e perdorimit te tyre :

- perdorim te vet (per ofrim te sherbimeve te komunikimeve elektronike)
- ofrim per pale te treta (dhenie me qera) duke specifikuar per operatore (ofrues) te sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe jo operatore (perdorues fundore p.sh. Banka, Institucione etj)

Informacioni te pershkruaje hapësirën që mbulon me kapacitete transmetuese, kombetare dhe nderkombetare, per te gjitha llojet e teknologjive, si linja bakri, lidhje me radiofrekuenca, fiber optike (perfshire dark fiber), lidhje satelitore etj, duke dhen edhe nje skeme te sistemit te transmetimit te rrjeti tuaj

b) Te pershkruani kapacitetet tranmetuese te marra me qera nga operatore te tjere, me qellim ofrimin e linjave me qera me pakice apo per qellim te ofrimit te sherbimeve te tjera te komunikimeve elektronike.

c) Informacioni i mesiperme te jape ne menyre te detajuar kapacitetet tranmetuese te zoteruara nga ju, te dhena me qera, dhe te marra me qera, duke specifikuar:

- kapacitetet ne Kbit/s apo Mbit/s
- distancat dhe vendodhjen
- tarifat e aplikuar (per dhenien dhe/ose marrjen me qera) sipas kapaciteteve, distances dhe vendodhjes;
- te ardhurat e siguruara nga ofrimi i kapaciteteve tranmetuese per vitin 2008 dhe vitin 2009;

### **Te dhenat te dergohen zyrtarisht ne AKEP, brenda dates 23.01.2010.**

Te dhenat e mesiperme jane te nevojshme per permiresimin e cilesise se te dhenave te depozituara ne AKEP, sipas Pyetsorit te publikuar nga AKEP, ne faqen e Internetit te AKEP me 16.06.2009.

Mos dergimi i ketyre te dhenave, bazuar ne Ligjin Nr.9918, dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” ne detyrim (te Neni 16), sanksionohet me gjobe sipas Neni 137, Paragrafi 1, Pika VII –te, te ligjit te sipercituar.

Gjithashtu per rastet qe AKEP dyshon per dhenie informacioni jo te sakte nga sipermarresi, do te perdore edhe kompetencen e verifikimit te te dhenave nepermjet inspektimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

**ANALIZE**  
**E**  
**TREGUT**  
**TE LINJAVE ME QERA**

- 1) Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
- 2) Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qera.
- 3) Tregu me shumice i linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.

**Dokument per Konsultim Publik**

**Nentor 2009**

# INDEKSI I PERMBAJTJES

<b>I. PERMBLEDHJE .....</b>	<b>4</b>
<b>II. HYRJE .....</b>	<b>12</b>
<b>II.1. PANORAME E SEKTORIT TE TELEFONISE FIKSE DHE LINJAVE ME QERA .....</b>	<b>12</b>
<b>II.2 PERCAKTIMI I SIPERMARRESVE ME FUQI TE NDJESHME NE TREG .....</b>	<b>14</b>
<i>I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator.....</i>	<i>14</i>
<i>II. Procesi i Konsultimit.....</i>	<i>15</i>
<i>III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences.....</i>	<i>15</i>
<i>IV. Struktura e Dokumentit .....</i>	<i>16</i>
<i>V. Perkufizimi i tregut perkates.....</i>	<i>16</i>
<i>VI. Fuqia e Ndjeshme ne Treg dhe masat rregulluese .....</i>	<i>18</i>
<b>III. LINJAT ME QERA: SEGMENTIMI I TREGJEVE DHE OFRUESIT .....</b>	<b>20</b>
<b>IV. ANALIZE E TREGUT ME PAKICE TE LINJAVE ME QERA: SETI MINIMUM .....</b>	<b>27</b>
<b>IV.1. PERKUFIZIMI I TREGUT ME PAKICE TE LINJAVE ME QERA.....</b>	<b>27</b>
<i>I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregut me pakice te linjave me qera .....</i>	<i>27</i>
<i>II. Dimensioni gjeografik i tregut.....</i>	<i>31</i>
<b>IV.2 ANALIZA PER FUQI TE NDJESHME NE TREGUN ME PAKICE .....</b>	<b>32</b>
<i>I. Pjeset e tregut .....</i>	<i>32</i>
<i>II. Pengesat per hyrje dhe Konkurrenca e mundshme ne tregun e linjave me qera.....</i>	<i>35</i>
<i>III. Fuqia kundervepruese e blesesve te linjave me qera .....</i>	<i>38</i>
<i>IV. Tarifimi i linjave me qera me pakice.....</i>	<i>38</i>
<i>VI. Perfundime mbi FNT.....</i>	<i>45</i>
<b>V. ANALIZE E TREGJEVE ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA: SEGMENTET TERMINUESE DHE TRUNK .....</b>	<b>48</b>
<b>IV.1 PERKUFIZIMI I TREGJEVE PERKATES ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA .....</b>	<b>48</b>
<i>I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregjeve me shumice te linjave me qera .....</i>	<i>48</i>
<i>II. Dimensioni gjeografik i tregut.....</i>	<i>50</i>
<b>IV.2 ANALIZA PER FNT: TREGJET ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA .....</b>	<b>52</b>
<i>I. Pjeset e tregut .....</i>	<i>52</i>
<i>II. Pengesat per hyrje dhe Konkurrenca e mundshme ne tregun e linjave me qera.....</i>	<i>54</i>
<i>III. Fuqia kundervepruese e blesesve te linjave me qera .....</i>	<i>57</i>
<i>IV. Tarifimi i linjave me qera me shumice .....</i>	<i>57</i>
<i>V Perfundim per FNT.....</i>	<i>59</i>
<b>VI. MASAT RREGULLUESE PER FNT NE TREGJET ME SHUMICE DHE ME PAKICE TE LINJAVE QERA .....</b>	<b>60</b>
<b>VI.1 PROBLEMET NE KONKURRENCE .....</b>	<b>60</b>
<b>VI.2 PERVOJA RREGULLATORE DHE REKOMANDIMET E BE PER LINJAT ME QERA .....</b>	<b>62</b>
<b>VI.3 MASAT RREGULLUESE PER FNT TE ALBTELECOM: LINJAT ME QERA ME SHUMICE DHE SETI MINIMUM I LINJAVE ME QERA ME PAKICE .....</b>	<b>65</b>
<i>Afatet e ofrimit te linjave me qera .....</i>	<i>67</i>
<i>Kontrolli i tarifave te linjave me qera dhe orientimi ne kosto.....</i>	<i>67</i>
<i>Standartet per linjat me qera me pakice, seti minimum .....</i>	<i>70</i>
<b>ANEKS 1. TARIFAT E ALBTELECOM PER LINJAT ME QERA .....</b>	<b>72</b>
<b>ANEKS 2. LISTA E STANDARTEVE DHE/OSE SPECIFIKIMEVE PER SETIN MINIMUM TE LINJAVE ME QERA (2003/548/EC). .....</b>	<b>75</b>
<b>ANEKS 3. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIM PUBLIK .....</b>	<b>76</b>

## INDEKSI I TABELAVE DHE FIGURAVE

FIGURE II .1 NUMRI TOTAL I LINJAVE ME QERA 2006-2008.....	12
SKEMA III.1. RRJET FIKS INKUMBENT DHE SEGMENTE TE LINJAVE ME QERA.....	21
SKEMA III.2: RJET FIKS INKUMBENT DHE ALTERNATIV.....	22
SKEMA III.3: RJET FIKS INKUMBENT DHE ALTERNATIV.....	24
TABELA IV.1 NUMRI I LINJAVE ME QERA TE ALBTELECOM: RAPORTIM PERIODIK DHE PER ANALIZEN .....	33
TABELA IV.2 NUMRI I LINJAVE ME QERA: RAPORTIM I OPERATOREVE PER ANALIZEN .....	33
FIGURA IV.1 PJESET E TREGUT TE ALBTELECOM: NUMRI DHE TE ARDHURAT PER LINJAT ME QERA.....	33
TABELA IV.3 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA KOMBETARE: ALBTELECOM DHE VODAFONE ....	38
TABELA IV.4 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA NDERKOMBETARE: ALBTELECOM DHE VODAFONE .....	39
TABELA IV.5 TARIFAT E LINJAVE ME QERA TE ASC.....	39
FIGURE IV.2 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA KOMBETARE 64KBIT/S: ALBTELECOM DHE SEE	40
FIGURE IV.3 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA KOMBETARE 2 MBIT/S: ALBTELECOM DHE SEE	40
FIGURE IV.5 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA NDERKOMBETARE 64KBIT/S: ALBTELECOM DHE SEE.....	41
FIGURE IV. KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA NDERKOMBETARE 2 MBIT/S: ALBTELECOM DHE SEE.....	42
TABELE IV.6 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA : ALBTELECOM DHE EU (EURO/MUAJ).....	42
TABELA V.1 NUMRI I LINJAVE ME QERA ME SHUMICE TE ALBTELECOM DHE AMC.....	52
TABELA V.2 PJESET E TREGUT TE LINJAVE ME QERA ME SHUMICE TE ALBTELECOM.....	53
TABELA V.3 KRAHASIMI I TARIFAVE TE LINJAVE ME QERA ME SHUMICE TE ALBTELECOM DHE BE.....	58
TABELA VI.1 PROPOZIMI PER RREGULLIMIN E TARIFAT ME PAKICE DHE ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA KOMBETARE TE ALBTELECOM.....	69
TABELA VI.2 PROPOZIMI PER RREGULLIMIN E TARIFAT ME PAKICE DHE ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA NDERKOMBETARE TE ALBTELECOM .....	69

## I. PERMBLEDHJE

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918) qe hyri ne fuqi me 26.06.2009, ne nenin 1 te tij, percakton se Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë efçente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky dokument permban analizen e tregjeve me pakice dhe me shumice te linjave me qera, apo tregjet nr.7, 12 dhe 13 te Rregullores se Analizes se Tregut (ne vijim referuar si Rregullore):

- 1) Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
- 2) Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qera.
- 3) Tregu me shumice i linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.

Ne perfundim te procesit te kesaj analize te nisur, AKEP do te marre vendime ne lidhje me FNT si dhe masat rregulluese te nevojshme ne rast te gjetjes se FNT ne tregjet e analizuara

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 "Per komunikimet elektronike ne RSH", parashikon ne Nenin 35 te tij proceduren e keshillimit me palet e interesit per analize e tregut duke vendosur si afat periudhen kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara. Ne kete menyre, AKEP mirepret komentet e paleve te interesuara deri 60 dite nga data e publikimit ne faqen e Internetit te AKEP, per perfundimet ne lidhje me FNT dhe detyrimet e propozuara nga AKEP per FNT. Komentet e paleve te interesuara do te publikohen nga AKEP, se bashku me dokumentin final te analizes se tregut dhe vendimet per FNT. Ne cdo seksion ka pyetje per komente nga palet e interesuara, por palet mund te japin komente per cdo pjese te ketij dokumenti.

### **Nga analiza e tregut me pakice te linjave me qera rezulton:**

Linjat me qera me kapacitet te ulet (deri ne dhe perfshire 2mbits) jane pjese e te njejtit treg perkates;

Linjat me qera me kapacitet te larte (mbi 2mbits), nuk jane pjese e tregut perkates te linjave me qera me kapacitet te ulet.

Linjat me qera me kapacitet te ulet, linjat analoge dhe linjat dixhitale jane pjese e te njetit treg perkates.

Linjat me qera nderkombetare jane pjese e te njejtit treg perkates me pakice te linjave me qera kombetare.

Sherbimet e menaxhuara nuk jane pjese e te tjetit treg perkates me pakice te setit minimal te linjave me qera me kapacitet deri ne dhe perfshire 2mbits.

*Dimensioni gjeografik i shërbimit të linjave me qera është kombëtar, d.m.th territori i Republikës së Shqipërisë.*

Percaktimi i tregut me pakice të linjave me qera është:

- **Tregu i setit minimum të linjave me qera, përfshin linjat me qera deri në dhe përfshirë 2Mb/sek, analoge dhe dixhtale;**
- **Dimensioni gjeografik i tregut është kombëtar**

Nga të dhënat e raportuara nga Albelem në mënyrë periodike, rezultoi se numri i linjave me qera të ofruara nga Albelem është shumë më i madh se numri i deklaruar nëpërmjet pyetsorit të dërguar për këtë Analizë Tregu (shiko tabelën IV.1)

Bazuar në të dhënat e deklaruara të operatorëve, sipas pyetsoreve:

- Albelem zoteron mbi 50% pjesë tregu në numrin e linjave me qera dhe të ardhurave prej tyre:
- pjesët e tregut të operatorëve të tjerë për vitin 2008 variojnë nga zero deri në 31% për numrin e linjave me qera dhe zero deri në 25% për të ardhurat.

Albelem është aktualisht operator me FNT në tregun me pakice të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe është propozuar perseri (Analiza 2009 telefonise fikse-Konsultim publik) si operator me FNT në këtë treg. Statusi me FNT në këtë treg, është faktor që konsiderohet i rëndësishëm për të shtrirë FNT në tregun me pakice (dhe me shumicë të segmenteve terminuese-lokale) të linjave me qera.

Zevendesimi i sistemit të komplikuar të licensimit me licensa të klasave të ndryshme dhe për zonë operimi të parçaktuara me sistemin e autorizimit të përgjithshëm përben një eliminim apo reduktim të ndjeshëm të pengesave ligjore në ofrimin e linjave me qera me pakice.

Megjithatë eliminimin apo reduktimin e ndjeshëm të pengesave ligjore, që erdhi si pasojë e Ligjit 9918 dhe kuadrin rregullator të autorizimeve të përgjithshme, Albelem vazhdon të ketë avantazhe ndaj operatorëve të tjerë për shkak të ekonomive të shkallës, ekonomive të densitetit, integritetit vertikal. Këto avantazhe të Albelem, në rrjetin lokal dhe backbone, ndikojnë pozitivisht në aftësinë ndikuese të Albelem në tregjet me pakice të linjave me qera.

Ofrimi i linjave me qera është i varur nga vendodhja e ambienteve që do lidhen, dhe avantazhet e Albelem të lidhur me prezencën në rrjet në nivel kombëtar, ulin aftësinë negociuese të blerësve, pasi Albelem shpesh është i vetmi operator që mund të sigurojë shërbimin e kërkuar nga blerësi.

Albelem nuk ka ndjere presion konkurrues të tilla që të ofrojnë tarifa të linjave me qera të orientuara në kosto;

Tarifat e linjave me qera të Albelem kanë disproporcione të konsiderueshme në strukturën e tyre:

- tarifa shumë më të larta për kompanitë e telekomunikacioneve se kompanitë që i blejnë linjat me qera ndërkombëtare për përdorim fundor është kunder

praktikes se tarifave me te uleta me shumice ne krahasim me tarifat me pakice, dhe perben sjellje antikonkurrese:

- shitja e linjave me qera nderkombetare kompanive te telekomunikacioneve qe i perdorin linjat per ofrimin e sherbimeve me pakice, eshte shitje me shumice dhe keto tarifa duhet te jene me te uleta se tarifat e perdorueve fundore te linjave me qera.
- Tarifat e linjave me qera kombetare 2 Mbit/s jane disa here me te uleta se tarifat e vendeve te rajonit dhe BE (situat e kundert me periudhen para vitit 2005<sup>1</sup> ku keto tarifa ishin disa here me te larta se tarifa mestare e vendeve te BE);
- Diferencat ne tarifat e linjave me qera 64 kbit/s me 2 mbit/s jane shume me te ulet se ne vendet e BE : 40-100% krahsuar me 250-460% ne vendet e BE;
- Tarifat e linjave me qera te Albtelecom nuk kane pesuar asnje ndryshim qe prej vitit 2005;

Duke marre ne konsiderate faktoret (argumentat) e mesiperm, AKEP gjykon se:

**Albtelecom permbush kriteret per fuqi te ndjeshme ne tregun perkates me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)**

---

<sup>1</sup> Tarifat e linjave me qera jane reduktuar ndjeshem nga Albtelecom gjate vitit 2005 : pe qarqet 2 Mbit/s reduktimi ishte afersiht 10 here : 2000 euro/muaj ne 220 Euro/muaj.

## **Nga analiza e tregjeve me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk te linjave me qera, rezulton:**

Ndarja e sgementeve terminues dhe sgementeve trunk te linjave me qera:

- “Terminime Lokale te Linjave me qera” jane pjese te linjave me qera qe lidhin centralin lokal me ambientet apo ndertesat e klientit
- Trank Segmente ose Trank Seksione jane pjese te linjave me qera qe ndodhen mes dy nyjave kryesore te rrjetit te ndertua: lidhja midis centraleve lokale dhe tranzite.
- Kufiri ndares midis segmenteve terminuese dhe trunk eshte centrali qe lidhet direkt me perdoruesin fundor te linjes me qera;

Ofrimi i linjave me qera nje operatori apo ofruesi rrjetesh apo sherbimesh te komunikimeve elektronike, si inpute per aktivitetin e ketij operatori/ofruesi (shitje me pakice, pjese rrjeti etj), perben shitje me shumice te linjave me qera.

Kerkesa per linja me qera me shumice eshte kerkese e derivuar nga tregjet me pakice te linjave me qera si edhe nga kerkesa per sherbime te tjera te komunikimeve elektronike.

Linjat me qera me shumice dhe PPC apo LLPC jane pjese e te njejtit treg perkates, dhe pjese e tregjeve me shumice te segmenteve terminuese dhe segmenteve trunk te linjave me qera.

Segmentet terminuese dhe segmentet trunk te linjave me qera, sipas ndarjes se cituar me siper, jane pjese e tregjeve perkates te ndryshem,

Tregjet perkatese me shumice te linjave me qera, segmenteve terminuese dhe trunk, perfshijne te gjitha kapacitetet e linjave me qera.

Dimensioni gjeografik i sherbimev me shumice, segmenteve terminuese dhe segmente trunk te linjave me qera eshte kombetar, d.m.th territori i Republikes se Shqiperise.

Nga pyetsoret e derguar operatoreve per kete anlyze tregu, rezulton se koncepti i shitjes me shumice te linjave me qera nuk eshte i zhvilluar apo konsoliduar ne Shqiperi.

Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 50% te linjave me qera, per numrin e linjave me qera dhe per te ardhurat.

Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rëndësishem per te shtrire FNT ne tregjet me shumice te segmenteve terminuese-lokale te linjave me qera.

Zevendesimi i sistemit te komplikuar te licensimit me licensa te klasave te ndryshme dhe per zona operimi te parcaktuara me sistemin e autorizimit te pergjithshem perben nje eliminim apo reduktim te ndjeshem te pengesave ligjore ne ofrimin e linjave me qera me pakice.

Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me operoret alternative dhe celulare dhe operatore te rinj te mundshem ne treg, per ofrimin e linjave lokale te telefonise fikse dhe ne kete menyre edhe per ofrimin e linjave me qera.

Megjithë eliminimin apo reduktimin e ndjeshëm të pengesave ligjore, që erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrin rregullator të autorizimeve të pergjithshme, Albtelecom vazhdon të ketë avantazhe ndaj operatoreve të tjerë për shkak të ekonomive të shkallës, ekonomive të densitetit, integritit vertikal. Këto avantazhe të Albtelecom, në rrjetin lokal dhe backbone, ndikojnë pozitivisht në aftësinë ndikuese të Albtelecom në tregjet me shumicë të linjave me qera.

Ofrimi i linjave me qera është i varur nga vendodhja e ambienteve që do lidhen, dhe avantazhet e Albtelecom të lidhur me prezencën në rrjet në nivel kombëtar, ulin aftësinë negociuese të blerësve, pasi Albtelecom shpesh është i vetmi operator që mund të sigurojë shërbimin e kërkuar nga blerësi.

Aplikimi nga Albtelecom i tarifave shumë me të larta për kompanitë e telekomunikacioneve të kompanitë që i blejnë linjat me qera ndërkombëtare për përdorim fundor është kundër praktikës së tarifave me të ulëta me shumicë në krahasim me tarifën me pakicë,

Tarifat e linjave me qera kombëtare me shumicë 2 Mbit/s janë disa herë me të ulëta se tarifën me pakicë të vendeve të rajonit dhe BE (situatë e kundërt me periudhën para vitit 2005<sup>2</sup> ku këto tarifa ishin disa herë me të larta se tarifa mestare e vendeve të BE);

- Diferencat në tarifën e linjave me qera 64 kbit/s me 2 mbit/s janë shumë me të ulët se në vendet e BE : 40-100% krahasuar me 250-460% në vendet e BE;
- Tarifat e linjave me qera të Albtelecom nuk kanë pësuar asnjë ndryshim që prej vitit 2005;

Tarifat e Albtelecom për qarqet ndërkombëtare me shumicë (operatoreve të telekomunikacioneve) 64 kbit/s:

- Janë me të larta se tarifën me pakicë në rajonin SEE dhe 85% me të larta se mesatarja e BE;

Tarifat e Albtelecom për qarqet ndërkombëtare me shumicë (operatoreve të telekomunikacioneve) 2 Mbit/s:

- Janë me të larta se tarifën me pakicë në rajonin SEE dhe 76% me të larta se mesatarja e BE;

AKEP gjykon se sipërmarrësi Albtelecom sh.a përmbush kriteret për FNT në:

- **tregun me shumicë të segmenteve të linjave me qera;**
- **tregun me shumicë të segmenteve të linjave me qera**

---

<sup>2</sup> Tarifat e linjave me qera janë reduktuar ndjeshëm nga Albtelecom gjatë vitit 2005 : për qarqet 2 Mbit/s reduktimi ishte afërsisht 10 herë : 2000 euro/muaj në 220 Euro/muaj.

## **Masat Rregulluese dhe detyrimet per Albtelecom si operator me FNT ne Tregjet me shumice dhe me pakice (seti minimum) te linjave me qera**

Ofrimi i linjave me qera ne kushtet e konkurrences efektive, apo i rregulluar ne menyre efektive, do krijojte kushtet per nje mundesi zgjedhjeje, si dhe cmime dhe cilesi te favorshme per bizneset dhe institucionet e mesme dhe te medha si dhe per sipermarresit e rrjeteve/sherbimeve te komunikimeve elektronike, duke bere nje kontribut te rendesishem ne ekonomine Shqiptare ne teresi.

Nder problemet e evidentuara, pervec tarifimit, ne ofrimin e linjave me qera nga Albtelecom:

- mungesa e ofrimit te linjave me qera me kapacite te larta 34mbit/s, 155mbit/s
  - o Shqiperia eshte i vetmi vend ne rajon qe nuk ka ofrim te linjave 34 mbit/s nga operatori fiks inkumbent.
- mungesa e marrveshjeve te nivelit te sherbimit per afatet dhe cilesine e ofrimit linjave me qera (me shumice dhe me pakice);
- mos-ofrimi i linjave te pjesshme me qera me shumice operatoreve te tjere;
- mosdhenia e aksesit per linjat me qera me shumice dhe diskriminimi i operatoreve te telekomunikacioneve (ofruesve te sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike);

Bazuar ne evidentimin e problemeve qe ekzistojne dhe qe mund te lindin ne ofrimin e linjave me qera me pakice, seti minimum, dhe te linjave me qera me shumice, AKEP gjykon se masat e nevojshme ne nivelin me shumice te ofrimit te linjave me qera nga Albtelecom, me reference ne parashikimet e Ligjit 9918, jane:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Detyrimete mesiperme midis te tjerave perfshijne:

- o Publikimin e ofertes reference te aksesit ne rrjetin Albtelecom per linjat me qera me shumice.
- o Albtelecom duhet te mos diskriminoje midis operatoreve te ndryshem dhe midis operatoreve te tjere dhe klienteve, filialeve te veta;
  - Bazuar ne kete detyrim, Albtelecom do te duhet te reduktojte tarifat e linjave me qera nderkombetare per kompanite e telekomunikacioneve, ne nivele te pakten te njejte me klientet e tij me pakice (shiko me poshte)
  - detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin me shumice dhe me pakice te linjave me qera.
  - detyrimin per te bere te disponueshem inputet e nevojshme me shumice per produktet/ sherbimet e reja apo te permiresuara me pakice;
  - Detyrimi per te ofruar marrveshje te Nivelit te Sherbimit (service level agreement-SLA)
  - Detyrimi per te paguar kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimit te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort.
- o Albtelecom do te duhet te jape akses per linja me qera me shumice ne rrjetin e vet, linja te cilat perfshijne:

- Linja me qera me shumice: linja te njejta si linjat e ofruara klienteve fundore, me ndryshimin se bleresi eshet nje kompani telekomunikacioni apo sipermarres i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike (rregjistruar ne AKEP);
- Qarqe te pjesshme me qera (Leased line partial Circuits): qarqe transmetimi qe lidhin nje klient fundor te operatorit tjetër me piken e interkoneksionit te Albtelecom me operatorin tjetër si dhe qarqet e transmetimit te ofruar nga Albtelecom operatoreve te tjere per tu perdorur ne interkoneksionin e ndermjetem apo ne anen e klientit.
- Ofrimin me shumice te linjave me qera ethernet;
- Kapaciteti i linjave te dhena nga Albtelecom do te jete ne varesi te kerkeses se bleresit, duke perfshire dhe qarqet 34 mbit/s dhe 155 mbit/s. Rastet e pamundesise teknike te ofrimit nga Albtelecom, do et duhet te justifikohen me shpjegime te plota, bazuar ne rregullat dhe proceduar e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);

AKEP gjykon se nder detyrimet per Albtelecom, per ofrimin e Marrveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement\_SLA), te perfshije afatet maksimale te sigurimit te linjave me qera, me pakice dhe me shumice, ne perputhje me rekomandimin 2005/57/EC.

Per shkak te problemeve te evidentuara ne tarifimin e linjave me qera me pakice, seti minimum, dhe me shumice te Albtelecom, si dhe per shkak te pamjaftueshmërsise se masave te tjera rregulluese per te eliminuar problemet e tarifave te linjave me qera, AKEP gjykon se tarifat e linjave me qera me shumice dhe me pakice te Albtelecom duhet te jene subjekt kontrolli, dhe ne zbatim me nenin 5/a te ligjit, keto tarifa nuk duhet te jene me te medha se niveli mesatar i vendeve te BE. Per metoden e rregullimit te tarifave, AKEP gjykon qe fillimisht, per nje periudhe 1 vjecare te aplikojë metoden e cmimit tavan apo maksimal, duke perdorur si reference nivelin mesatar te vendeve te BE, apo praktiken me te mire te vendeve te BE. Keto metoda jane te parashikuara ne nenin 57, pika 1/a dhe 2/a dhe 2/b.

Per periudhe afatgjate, AKEP gjykon se tarifat e orientuara ne koston efciente te ofrimit te linjave me qera, eshte metoda me mire e tarifimit, dhe metoda LRAIC e rekomanduar nga KE, eshte metoda me e mire per nxitjen e konkurrences efektive ne ofrimin e linjave me qera dhe sherbimeve et tjere ta komunikimev elektronike.

Per linjat me qera me pakice dhe me shumice (perfshire qarqet e pjesshme te linjave me qera te dhena operatoreve per interkoneksion) te cilat kane tarifa me te uleta se mesatarja e vendeve te BE, AKEP gjykon qe keto tarifa te mos ndryshojne deri ne justifikimin e koston se tyre nepermjet modelit BULRAIC. AKEP pas marrjes se rezultateve dhe rekomandimeve te ketij projekti (fillimi i vitit 2010), gjykon se do jete nevojshme te zhvilloje nje konsultim publik per marrjen nje vendimi per rregullimin e tarifave te linjave me qera, perfshire rregullimin e tarifave qe aktualisht jane nen nivelin mesatar te BE.

AKEP propozon Rregullimin e tarifave me shumice duke u bazuar ne tarifen me pakice te sherbimit, minus nje perqindje, e cila vleresohet te jete e arsyeshem dhe qe normalisht mbulon koston e marketingut per shitjen me pakice nga operatori incumbent. Vlera e zbritjes e perdorur normalisht eshte 20%.

Tarifat e linjave nderkombetare me pakice do te kene tarifa maksimale te barabarte me mesataren e vendeve te BE, ndersa te njejtat linja por qe iu ofrohen sipermarresve ofrues te rrjetevee dhe/ose sherbimeve te komunikimeve eltronike do te kene tariaf 20% me te uleta (pjesa qe i paguhet Albtelecom).

Si tarifa reference per tarifaf mesatare te linjave me qera me pakice te vendeve te BE, do ti referohemi te dhenave te publikuara ne dokumentat:

*European Commission: Progress Report on the Single European Electronic Communications Market 2008 (14th Implementation Report)*

*Report on Telecoms Price Developments from 1998 to 2007. Prepared by Teligen December 2007, for European Commission, Directorate General for Information Society*

Ne lidhje me standartet e grupit minimal (apo setit minimum) te linjave me qera AKEP propozon qe Albtelecom ne ofrimin e linajve me qera me pakice, deri ne dhe perfshire 2 Mbit/s, te aplikoj standartet e rekomanduara nga rekomandimi i KE 2003/548/EC.


## II. HYRJE

### II.1. Panorame e sektorit te telefonise fikse dhe linjave me qera

Numri i perdoruesve te telefonise fikse, apo linjave telefonike qe perfundojne ne vendodhjet fikse (adresat) e perdorueve te tyre, dhe mbulimi me rrjet dhe kapacitete transmetuese i territorit, luajne nje rol te rendesishem ne ofrimin e linjave me qera. Numri i perdoruesve te telefonise fikse deri me 1 Korrik 2009 vleresohet te jete afersisht 360 mije, apo afersisht nje rritje me 15% krahasuar me 1 Korrik 2008. Kjo rritje ka ardhur si pasoje e rritjes se numrit te perdoruesve te operatoreve alternative dhe rritjes ne gjashtemujorin e pare te vitit 2009 te numrit te perdoruesve te Albtelecom, i cili ka pasur nje rritje te ndjeshme prej 11% ne krahasim me te njejten periudhe ne vitin 2008 apo me vitet e tjera para-ardhese, te cilat jane karakterizuar nga norma shume te vogla rritjeje prej 1-2%.

Ofrimi i linjave me qera eshte bere kryesisht nga operatori Albtelecom, por investimi ne rrjete dhe kapacitete transmetimi nga operatoret alternative te rrjeteve fikse dhe operatoret celulare, kane bere te mundur ofrimin e linjave me qera edhe nga keta operatore. Ne Figure II.1, pasqyrohet ecuria e numrit total te linjave te dhena me qera nga operatoret e rjeteve te telefonise fikse dhe celulare, te cilat i referohen te dhenave periodike dhe te dhenave te raportuara per pyetsorin e kesaj analize tregu. Ka nje mosperputhje ne te dhenat periodike dhe te dhenat e derguara nepermjet pyetsorit per Analizen, te raportuara nga Albtelecom, dhe kjo rezulton ne dy grafike te ndryshem.

FIGURE II .1 NUMRI TOTAL I LINJAVE ME QERA 2006-2008



Norma e penetrimit, apo numrit te perdorueve per 100 banore, te linjave fundore te telefonise fikse, me 1 Korrik 2009 eshte 11.3%, e cila eshte shume me e ulet se mesatarja ne vendet e BE (45%) dhe te rajonit, si dhe shume me eulet se norma e penetrimit te sherbimeve celulare ne Shqiperi, e cila ne 1 Korrik 2009 arriti ne 110%, apo 3.52 milione perdoures celulare (te matur me numrin e kartave SIM ne perdorim)

Ofrimi i linjave me qera mund te kryhet nga cdo operator rrjeti i cili zoteron kapacitete transmetuese njekohesisht investon ne linja per te lidhur perdorues fundore me rrjetin e transmetimit. Operatoret rrjeteve fikse zoterojne kapacitete transmetimi dhe njekohesisht linja fundore, dhe kane te mundur ofrimin e linjave me qera. Nderkohe operatoret e rrjeteve celulare, nuk kane linja fundore por mund te bejne lidhjen fizike sipa kerkesave te perdoruesve.

Ofrimi i linjave me qera per cdo operator varet nga mbulimi territorial me rrjet. Albtelecom dhe operatoret celulare kane mbulim kombetar me rrjet, dhe kane operuar me licensa te Klasit te I, apo kombetare deri ne zevendesimine tyre me Autorizime individuale dhe te pergjithshme. Operatoret Alternative kane kryesisht mbulim rajonale, dhe deri ne hyrjen ne fuqi te Ligjit 9918, dhe zvendesimin e sistemit te licensimit me autorizime kane pasur kufizime territoriale per ofrimin e sherbimeve te yre, perfshire ofrimin e linjave me qera, qe ka qene pjese e te drejtave te licensave te zoteruara prej tyre.

## II.2 Percaktimi i sipermarresve me Fuqi te Ndjeshme ne Treg

### I. Objektivat e Ligjit dhe kuadri rregullator

Ligji nr.9918, date 19.05.2008 "Per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" (ne vijim Ligji 9918) qe hyri ne force me 26.06.2009, ne nenin 1 te tij, percakton se Qëllimi i ligjit është që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 i Ligjit 9918, Objektivat Rregullatore, percakton midis te tjerave:

AKEP-i nxit konkurrencën eficiente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:

- a) për t' u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me nevoja të veçanta, që kundrejt tarifave ***në çdo rast jo më të larta se tarifat mesatare të vendeve të BE-së***, mbi bazën e përzgjedhjes të përfitojnë maksimalisht shërbime alternative, cilësore dhe në përputhje me standardet e miratuara nga AKEP-i;
- b) për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për të mbrojtur të dhënat personale dhe privatësinë e përdoruesve;
- ç) për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në sektorin e komunikimeve elektronike;
- d) për të siguruar integritetin dhe sigurinë e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike;
- dh) për të nxitur investimet eficiente në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe zhvillimet e reja teknologjike për një cilësi të lartë të produkteve të tyre;
- ë) për të siguruar mosdiskriminimin dhe barazinë në trajtimin e ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kapitulli VI, Rregullimi i Konkurrences, permban percaktimet per rregullimin e konkurrences ne tregun e komunikimeve elektronike, dhe perfshin ndermjet te tjerave detyrimin e AKEP per kryerjen e anlizes se tregut per vleresimin e konkurrences efektive dhe percaktimin e sipermrresve me fuqi te ndjeshme ne treg. Kreu VI, permban gjithashtu kriteret e perdorura nga AKEP per vleresimin e fuqise se ndjeshme ne treg, detyrimet/masat rregulluese ne rast te gjetjes se FNT.

Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin per nje rregullore per analizen e tregjeve dhe percaktimin e FNT. AKEP me vendimin Nr.747, date 17.07.2009, ka miratuar Rregulloren per Analizen e Tregjeve (ne vijim referuara si Rregullorja). Rregullorja percakton midis te tjerave nje liste prej 18 tregjeve per tu analizuar nga AKEP per FNT, si dhe detyrimi per te kryer analizen e tre kriterëve per tregjet qe nuk jane pjese e rekomandimit Rekomandimit te Komisionit European, datë 11 Shkurt 2003.

Ligji 9918 eshte ne linje me direktivat e KE te vitit 2003 dhe metodologjia e analizes se tregjeve e percaktuar ne Ligj dhe ne Rregullore, percakton se AKEP duhet te marre ne konsiderate rekomandimet e Komisionit European.

Disa nga Rekomandimet dhe udhezimet e KE-se te marra ne konsiderate nga AKEP jane si më poshtë:

- Udhëzuesi e komisionit për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet të komunikimit elektronik (ne vijim referuar si Udhëzimi i KE)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 11 shkurt 2003, për produktet dhe shërbimet përkatëse të tregut brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregullara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2003/311/EC, OJ L 114, 8.5.2003, p. 45)
- Rekomandimi i Komisionit, datë 17 dhjetor 2007 për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2007/879/EC, OJ L 344, 28.12.2007, p. 65)

## **II. Procesi i Konsultimit**

Ligji Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne RSH”, parashikon ne Nenin 35 te tij proceduren e keshillimit me palet e interesit per analize e tregut duke vendosur si afat periudhen kohore prej 60 ditesh. Njekohesisht neni 36 percakton se AKEP vendos, ndryshon mban ose heq detyrime per FNT pas keshillimit me palet e interesuara. Ne kete menyre, AKEP mirepret komentet e paleve te interesuara deri 60 dite nga data e publikimit ne faqen e Internetit te AKEP, per perfundimet ne lidhje me FNT dhe detyrimet e propozuara nga AKEP per FNT. Komentet e paleve te interesuara do te publikohen nga AKEP, se bashku me dokumentin final te analizes se tregut dhe vendimet per FNT. Ne cdo seksion ka pyetje per komente nga palet e intersuara, por palet mund te japin komente per cdo pjese te ketij dokumenti.

Ne rast se ka pale qe nuk do te deshironin te identifikoheshin ne publikimin e komenteve nga AKEP, apo pjese te komenteve te cilat i konsiderojne konfidenciale, keto pale duhet te bejne nje shenim per keto raste. AKEP do te gjykoje se cilat prej fakteve apo te dhenave kane natyre konfidenciale.

Gjithashtu gjate ketij procesi, AKEP do te kerkoje nga operatoret te dhena shtese per sektorin e telefonise celulare.

## **III. Bashkepunimi me Autoritetin e Konkurences**

Sipas Nenit 38 të Ligjit Nr.9918 dt. 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne RSH”, AKEP-i do të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës. Do të zbatohet Memorandumi i Mirëkuptimit (Nr. Prot. 1566/1, datë 29.08.2007) ndermjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve dhe në veçanti “Neni 6”, ku flitet per përcaktimin e tregut, përcaktimin e dominancës / përcaktimi i FNT.

Ne kete process do te perfshihet konform percaktimit te mesiperme ligjor si dhe te marreveshjes se bashkepunimit edhe Autoriteti i Konkurences, komentet e te cilit serish do te jene te perfshira ne versionin final te analizes, pas konsultimit publik.

## IV. Struktura e Dokumentit

Ky dokument permban analizen e tregjeve me pakice dhe me shumice te linjave me qera, apo tregjet nr.7, 12 dhe 13 te Rregullores:

- 1) Tregun me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qira deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
- 2) Tregun me shumice te segmenteve terminuese te linjave me qera.
- 3) Tregun me shumice te linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.

Ne baze te parashikimeve te Rregullores, analiza permban:

- perkufizimin e tregjeve perkatese;
- shqyrtimin e secilit treg perkates per te analizuar konkurrencen ne keto tregje dhe nese ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg, duke perdorur kriteret e percaktuara ne nenin 33 te Ligjit si dhe udhezimin e KE
- analizimin e problemeve ne tregjet ne te cilat nuk ka konkurrence efektive apo ku ka operatore me fuqi te ndjeshme ne treg
- detyrimet per operatoret me fuqi te ndjeshme ne treg

## V. Perkufizimi i tregut perkates

Ne kuader te analizave te kryera nga nje rregullator per qellime te analizes se konkurrences efektive dhe percaktimit te sipermarresit/sipermarresve me FNT, analiza e nje tregu perkates fillon me shqyrtimin e produkteve dhe sherbimeve qe konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg.

Ne Analizat e meparshme te tregjeve (2006, 2007 dhe 2009) ERT (AKEP) ka perdorur perkufizimin e tregut perkates te dhene ne Rregullore 2005, perkufizim i i marre nga Ligji per Mbrojtjen e Konkurrences:

***Treg perkates-*** jane produktet qe vleresohen si te zevendesueshme nga konsumatoret ose klientet e tyre, per sa u perket karakteristikave, çmimit dhe funksionit te tyre dhe qe ofrohen ose kerkohen nga ndermarrjet ne nje zone gjeografike me kushte te njejta konkurrence, zone kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.

Ky perkufizim eshte i ngjashem me perkufizimin e dhene ne Udhezimin e KE, pika 44 <sup>3</sup>, udhezim i perdorur nga ERT edhe ne Analize 2007. Per kete arsye si dhe duke qene se udhezimi i KE, eshte pjese e dokumentave te KE te referuara ne Rregullore, AKEP ne kete

---

<sup>3</sup> According to settled case-law, the relevant product/service market comprises all those products or services that are sufficiently interchangeable or substitutable, not only in terms of their objective characteristics, by virtue of which they are particularly suitable for satisfying the constant needs of consumers, their prices or their intended use, but also in terms of the conditions of competition and/or the structure of supply and demand on the market in question (32). Products or services which are only to a small, or relative degree interchangeable with each other do not form part of the same market (33). NRAs should thus commence the exercise of defining the relevant product or service market by grouping together products or services that are used by consumers for the same purposes (end use).

Analize do te perdore te njejten metodologji per percaktimin e produkteve/sherbimeve qe jane pjese e te njetit treg perkates, si dhe ne Analize 2007, sic eshte shtjelluar dhe ne paragrafet ne vijim.

Perkufizimi i tregut per nje sherbim merr parasysh efektin e zevendesueshmerise se produktit (ne anen e kerkeses dhe ofertes), si edhe dimensionin gjeografik. Nje instrument ndihmes qe perdoret per identifikimin e tregjeve eshte parimi i monopolistit hipotetik.

### ***Parimi i monopolistit hipotetik***

Nje produkt konsiderohet te perbeje nje treg me vete nese “monopolisti” (hipotetik) qe ofron produktin mund te rrise çmimin e ketij produkti per nje periudhe kohe jo tranzitore dhe te mos kete renie ne shitje deri ne nivelin qe kjo te jete jo- fitimprurese. Pra, rritja e çmimit duhet te jete fitimprurese dhe e qendrueshme-monopolisti te kete aftesine te mbaje çmimin mbi nivelin konkurrues.

Testi i monopolistit hipotetik kryhet per te analizuar produktet/sherbimet te cilat mund te bejne pjese ne te njetin treg duke marre ne konsiderate efektin e zevendesueshmerise se produkteve ne anen e kerkeses dhe/ose ofertes. Nese monopolisti perballet me kufizime nga ana e kerkeses- konsumatorit do te zhvendosen drejt konsumit te nje produkti tjeter, qe do ishte zevendesues dhe, nga ana e ofruesve- ofrues te tjere do te futeshin ne kete treg per te ofruar produktin me çmim dhe perfitim te larte, atehere produktet e tjera qe jane zevendesues te ngushte te produktit te analizuar duhet te perfshihen ne kete treg.

### ***Zevendesimi ne anen e kerkeses***

Nese nje subjekt, qe eshte monopol ne ofrimin e nje produkti/sherbimi, do te rriste çmimin e ketij produkti, çfare mundesish kane konsumatorit te zevendesojne perdorimin e ketij produkti me nje tjeter ?

Produkti/sherbimi qe analizohet krahasohet me produkte te tjere, nese ato mund te zevendesohen nga ana e konsumatorit. Nese konsumatorit mund te zevendesojne produktin e ofruar nga monopolisti hipotetik me nje produkt apo produkte te tjera, keto te fundit duhet te perfshihen ne perkufizimin e tregut perkates.

### ***Zevendesimi ne anen e ofertes***

Nese monopolisti hipotetik do te rriste çmimin e produktit/sherbimit per nje periudhe kohe jo tranzitore, a do te kishte presion nga ofrues te tjere te mundshem te ketij sherbimi? Operatore te tjere, te cilet nuk e ofrojne sherbimin ne fjale, mund te zhvendosin burimet e tyre ne drejtim te ofrimit te ketij sherbimi.

Ne zevendesimin ne anen e ofertes duhet te merren parasysh vetem operatore, te cilet mund te zhvendosin burimet e tyre drejt ofrimit te sherbimit te marre ne konsiderate, per nje kohe te shkurter dhe pa kosto te larta te pakthyeshme. Pra, operatore te rinj qe nuk jane ne treg nuk mund te merren parasysh, pasi reagimi i tyre ndaj nje rritjeje te çmimit te produktit nuk do te ishte i shpejte (ne periudhe afatshkurter) por do te kerkonte kohe per investime kapitale qe kerkojne nje periudhe afatgjate. Ofruesit e mundshem jane operatore qe ofrojne sherbime te tjera dhe lehtesisht per nje periudhe kohe te shkurter mund te prodhojne edhe produktin, çmimi i te cilit eshte rritur.

Efekti i operatoreve te rinj ne treg, qe duhet te kryejne investime kapitale, merret ne konsiderate vetem ne analizen e fuqise se ndjeshme ne treg, pra te konkurrences se mundshme qe keta operatore mund te ushtrojne.

Nje faktor tjetër që merret në konsideratë në perkufizimin e tregut perkates është nëse ekzistojnë kufizime të përbashkëta në tarifim (common pricing constraints) midis klientëve, shërbimeve apo zonave të ndryshme. Kjo do të thotë që operatori të mos jetë i pavarur në tarifimin e shërbimeve të ndryshme: s'ka mundësi të rrisë çmimin e një shërbimi pa reduktuar çmimin e një shërbimi tjetër, i cili në vetevetë nuk është zëvendësues për shërbimin tjetër.

## VI. Fuqia e Ndjeshme në Treg dhe masat rregulluese

Pekufizimi i FNT është dhënë në nenin 33 të ligjit:

*Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.*

Ky perkufizim është pothuajse i njëjti me perkufizimin e Direktives Kuader të KE 2002, neni 14<sup>4</sup> (EC 2002 Framework Directive).

Neni 33 i Ligjit përcakton gjithashtu kriteret kryesore që duhet merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrje me FNT, që do të thotë dominancë individuale, dhe për rastet kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrje me FNT apo dominancë e bashkuar. Perkufizimi i dominancës së bashkuar i dhënë në nenin 33 është si vijon:

*Dy ose më shumë sipërmarrës vlerësohen se kanë një pozitë zotëruese nëse edhe në mungesë të lidhjeve strukturore apo të lidhjeve të tjera, veprojnë në treg në një strukturë dhe mënyrë të tillë, e cilat e çon në një sjellje të bashkërenduar, në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët ose përdoruesit.*

Për përcaktimin e FNT, dominancë individuale apo e bashkuar, siç theksohet dhe në pikat 79 dhe 98 të Udhezimit të KE, kriteret e përdorur duhen marrë të gjithë në konsideratë dhe në kombinim me njëri tjetrin dhe jo në mënyrë të veçantë për secilin kriter me vetë, pasi evidencat e kriterëve të veçantë mund të mos jetë përcaktuese e FNT.

Analiza për FNT është një analizë e cila merr në konsideratë zhvillimet e kaluara dhe njëkohësisht tendencën për të ardhmen (forward looking), pasi mungesa e konkurrencës në të kaluarën nuk do të thotë që një treg nuk ka tendencë për të qenë në konkurrencë në të radhmen. Në këtë mënyrë Analiza krahas shqyrtimit të kriterëve për vlerësimin e konkurrencës efektive në treg në të kaluarën, bën vlerësimin se si pritet të evoluojë tregu në të ardhmen. Analiza kryhet për të shqyrtuar nëse një treg perkates vlerësohet të jetë në konkurrencë efektive në një periudhë të paktën 2 vjeçare, dhe mungesa e konkurrencës efektive është barazvlefshme me ekzistencën e fuqisë së ndjeshme në treg, prej një ose më shumë sipërmarrësish.

Ekzistenca e FNT do të thotë që në treg ka probleme të cilat identifikohen dhe në bazë të problemeve të evidentuara, propozohet marrja e masave rregulluese apo detyrim për t'u zbatuar nga sipërmarrësi/sipërmarrësit me FNT. AKEP në bazë të nenit 34, ka detyrimin që

---

<sup>4</sup> *'an undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, that is to say a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors customers and ultimately consumers''*

ne rast te gjetjes se FNT ne nje treg perkates te vendose nje disa apo te gjitha detyrimet e cilesuara ne nent 39-45 dhe neni 56 te Ligjit. Vendosja e detyrimeve/masav rregulluese per FNT duhet te marre ne konsiderate objektivat rregullatore te percaktuar ne Ligj.

Nese nga analiza arrihet ne perfundimin se tregu perkates eshte ne konkurrence efektive, pra nuk ka FNT, atehere AKEP nuk vendos detyrime dhe ne rast se ndaj sipermarrsesve jane vendosur detyrime (per shkak te statusit te meparshem me FNT) atehere AKEP i heq keto detyrime duke percaktuar dhe nje afat kohor jo me te gjate se 6 muaj per berjen efektive te tyre.

### **III. LINJAT ME QERA: SEGMENTIMI I TREGJEVE DHE OFRUESIT**

Ligji nr.9918, Neni 3, pika 14, perkufizon linjat me qera si me poshte :

*“Linje me qera” eshte nje sherbim qe perfshin ofrimin e kapaciteteve transmetuese ndermjet pikave te ndryshme te te njejtit rrjet ose te rrjeteve te ndryshme, pa perfshire funksionet komutuese te kontrolluara prej perdoruesit te vet.*

Ndersa pika 31, percakton si pike fundore :

*“Pika fundore e rrjetit” eshte pika fizike, ne te cilen nje pajtimtar ka akses ne rrjetin e komunikimeve publike. Ne rastin e rrjeteve, qe përfshijnë komutimin ose rrugëzimin pika fundore e rrjetit identifikohet si nje adresë specifike e rrjetit, e cila mund të lidhet me numrin ose emrin e nje pajtimtari.*

Komisioni European, ne rekomandimin e vitit 2003 (2003/311/EC) ka percaktuar tregjet perkates te linjave me qera ne dy nivele, me shumice dhe pakice, pasi kapacitetet e dedikuara apo linjat me qera mund te kerkohen nga perdorues fundore per te ndertuar rrjete apo lidhur vendodhje te ndryshme, ose mund te kerkohen nga sipermarres qe ofrojne sherbime tek perdoruesit fundore.

Udhezimi i KE per tregjet perkates i vitit 2003, ka percaktuar tre tregje ne lidhje me linjat me qera, nje ne nivel me pakice dhe dy ne nivel me shumice:

- 1) Tregu me pakice i minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)
- 2) Tregu me shumice i segmenteve terminuese te linjave me qera.
- 3) Tregu me shumice i linjave kryesore (trunk) te linjave me qera.

Ne nivelin me pakice, perkufizimi i tregut ka reference specifike me Direktiven e Sherbimit Universal, per ofrimin e setit minimum te linjave me qera. Seti minimum i linjave me qera i referohet qarqeve me qera te specifikuara me karakteristika te harmonizuara te cilat duhet te behen te disponueshem sipas disa kushteve te vecata ne te gjithe territorin kombetar. Udhezimi i KE sqaron se nuk eshte konsideruar e nevojshme te identifikohen tregje specifike per cdo kategori te linjave me qera, brenda ketij seti, pasi struktura e tregut per cdo nendarje eshte e ngjashme. Gjithashtu nuk eshte konsideruar e nevojshme per te zgjeruar tregun ne linja me qera me kapacitet me te madh se 2 Mbits, pasi supozohet se nderhyrjet ne nivelin me shumice te linjave me qera (segmentet terminuese dhe trunket) do te jene te mjaftueshme per te zgjidhur problemet qe mund te ekzistojne ne nivel me pakice per linjat me qera te kapaciteteve me te medha se 2Mbts.


Tregjet e perkufizuara ne Rekomandimin e KE, jane pjese e Rregullores se Analizes se Tregut te AKEP (ne piken 1, te nenit 3): Tregu nr.7, 12 dhe 13. Meqenese, keto tregje, tregu me pakice i setit minimum te linjave me qera dhe tregjet me shumice te segmenteve terminuese dhe segmenteve trunk te linjave me qera, jane pjese e listes se tregjeve te Rekomandimit 2003 te KE (2003/311/EC), bazuar ne piken 4, te nenit 3 te Rregullores, AKEP nuk e konsideron

te nevojshme te beje nje analize te tre kriterëve nese keto tregje jane tregje perkates te justifikueshem per nderhyrje ex-ante. Perkufizmi i ketyre tregjeve si tregje te justifikueshem per nderhyrje ex-ante eshte tashme nje praktike rregullatore e konsoliduar dhe e aplikuar ne te gjithë vendet anetare dhe kandidate te BE, si edhe me gjere. Ne vijim, AKEP ka bere nje pershkrim te ofrimit te sherbimeve te linjave me qera, ne nivel me pakice dhe me shumice, nga operatorët e rrjeteve dhe segmentimin/ndarjen e linjave me me qera sipas segmenteve perkates.

Ofrimi i linjave me qera behet i mundur nga perdorimi i infrastruktures se nje apo me shume rrjeteve. Tipikisht dhe tradicionalisht linjat me qera jane ofruar dhe ofrohen perdoruesve fundore nga operatori inkumbent i rrjetit fiks. Infrastruktura e nje rrjeti fiks inkumbent mund te ndahet ne dy pjese: rrjeti lokal qe lidh centralet lokale me pikat fundore te rrjetit tek abonentët e telefonise dhe rrjeti baze (core) i cili perbehet nga centralet tranzit dhe centralet lokale dhe lidhjet midis tyre (kabllo trunk).

Ne Skemen III.1, paraqitet ne menyre te pergjithshme nje rrjet fiks dhe ndarja e elementeve te tij per qellime te ofrimit te linjave me qera, duke prezantuar skematikisht trunk segmentet, segmentet terminuese lokale dhe seksionin nderkombetar.

**SKEMA III.1. RRJET FIKS INKUMBENT DHE SEGMENTE TE LINJAVE ME QERA**



Nje bleres me pakice kerkon nje linje te dedikuar me qera e cila te lidhe dy lokalitete p.sh dy zyra ne vendodhje te ndryshme gjeografike. Secila prej ketyre zyrave eshte e lidhur me nje central lokal (mund te jete edhe i njeiti central) te operatorit inkumbent (mund te jete dhe operator Alternativ), dhe perbejne pike fundore ne kete rrjet. Operatori ofron lidhjen e dy pikave me kapacitet te dedikuar, sipas kerkeses se bleresit, dhe linja me qera megjithese

kalon nepermjet centraleve lokale (dhe te tjere) nuk perfshijne komutimin, por vetem transmetimin e sinjaleve.


Linja me qera, e cila eshte treguar me vije te kuqe, mund ti kete te dy fundet ne territorin e Shqiperise (pika A dhe B), dhe ne kete rast eshte linje me qera kombetare, por mund te ndodhe qe njera pike te ndodhet jashte Shqiperise, pika C, dhe ne kete rast linja e ofruar eshte linje me qera nderkombetare. Per te ofruar linjen nderkombetare, lidhjen midis pikave A dhe C, operatori vendas duhet te lidhet me operatore te huaj qe bejne te mundur ofrimin e infrastruktures nga pika e lidhjes me operatorin vendas deri ne piken tjetere fundore C.

Per ofrimin e linjes me qera, ne nivel me pakice dhe me shumice, infrastruktura e operatorit mund te ndahet ne disa segmente: segmentet e terminimit te linjave me qera dhe segmente tranke te tyre.

Ofrimi i linjave me qera ne nivelin me pakice perfshin ofrimin e kapaciteve transmetuese midis dy pikave fundore te rrjeteve te komunikimeve publike. Keto pika fundore mund te ndodhen ose jo ne te njejtin rrjet. Ne raste te tilla eshte e nevojshme qe operatoret e rrjeteve te bashkerendojne ofrimin e nje linje me qera duke dhene pales tjeter (operator) kapacitete nga rrjeti i tyre. Keto kapacitete mund te jene linja qe bashkojne piken fundore te rrjetit me nje central lokal, pjese nga kapacitete qe lidhin centrale te ndryshme (ne hieraki te njejte ose jo) apo nje kombinim i tyre.

Ne Skeme III.2, paraqiten dy rrjete: operatori inkumbent dhe nje operator alternativ rrjeti fiks. Rrjeti i operatorit alternativ mund te jete si ne figure por edhe me i madh duke pasur edhe seksion nderkombetar apo dhe me i vogel duke mos pasur nje rrjet lokal apo seksione trunk. Te dy rrjetet mund te interkonektohen ne pika te ndryshme te tyre, per qellime te transferimit te thirrjeve apo te te dhenave tek njeri tjetri, si dhe per te bere te mundur ofrimin e linjave me qera perdoruesve fundore.

**SKEMA III.2: RJET FIKS INKUMBENT DHE ALTERNATIV**



Sic mund te vihet re, bleresi me pakice i linjes me qera kerkon nje linje me qera qe te lidhe dy pikat fundore te cilat ndodhen ne rrjete te ndryshme (per shkak se p.sh ndodhen ne zona te ndryshme mbulimi ). Per te realizuar kete lidhje te dedikuara midis ketyre dy pikave fundore (vija e nderprere me ngjyre te kuqe) eshte e nevojshme qe te perdoret infrastruktura e te dy rrjeteve. Nese supozojme se bleresi me pakice i kerkon sherbimin OA, atehere OA duhet te bleje nga operatori tjetër (inkumbent ne kete rast) pjesen tjetër te linjes qe kalon nga pika e interkonektimit midis rrjeteve deri ne piken tjetër fundore te bleresit. Sherbimi qe do te bleje mund te ndahet ne dy pjese ne rrejtin e operatorit inkumbent: segmenti trunk (vija me ngjyre blu) dhe segmenti terminimit lokal (vija me ngjyre te kuqe). Keto pjese te rrejtit inkumbent, qe jane kapacitete brenda rrejtit inkumbent, i shiten nje operatori tjetër me qellim qe ky i fundit te kete mundesine ti ofroje sherbimin e linjes me qera bleresit fundor. Operatori apo ofruesi alternativ ne kete rast mund edhe te bleje me shumice te gjithë linjen me qera nga inkumbenti dhe ta shese me pakice tek nje perdorues fundor.

Ne kete rast, kerkesa e operatoreve per kapacitete te dedikuara ne rrejtin e nje operatori tjetër eshte kerkese e derivuar nga kerkesa e bleresve fundore per linja me qera. Por kerkesa e nje operatori per kapacitete ne rrejtin e nje operatori tjetër mund te jete me qellim ofrimin e sherbimeve te tjera, te ndryshme nga linjat me qera.

Ne skemat e mesiperme duhet te kemi parasysh gjithashtu:

- skemat jane ilustrative: skema e rrjeteve mund te jete e ndryshme nga sa eshte paraqitur si dhe ne rolin e operatorit inkumbent mund te jete dhe nje operator alternativ (i ndryshem nga operatori inkumbent);
- segmentet e kerkuar nga OA mund te jene: vetem segment lokal, vetem segment trunk ose nje kombinim i tyre;
- ofrimi i segmenteve/kapaciteteve te dedikuara nga nje operator nje operatori tjetër eshte sherbim me shumice, pasi nuk jane per perdorim fundor nga bleresi.

Per sa me siper, ne lidhje me kufijte ndarjes se segmenteve te linjave me qera, AKEP gjykon se :

- Linja me qera me pakice perfshin te gjithë elementet e nje apo me shume rrjeteve per te siguruar kapaciteteve transmetuese ndermjet dy pikave te ndryshme, pa perfshire funksionet komutuese te kontrolluara prej perdoruesit te tyre. Ofruesi i linjes me qera me pakice eshte operatori qe ka lidhje direkte me bleresin e saj;
- **“Terminime Lokale te Linjave me qera”** jane pjese te linjave me qera qe lidhin centralin lokal me ambientet apo ndertesat e klientit
- ***Trunk Segmente ose Trunk Seksione*** jane pjese te linjave me qera qe ndodhen mes dy nyjave kryesore te rrejtit te ndertua: lidhja midis centraleve lokale dhe tranzite.
- Kufiri ndares midis segmenteve terminuese dhe trunk eshte centrali qe lidhet direkt me perdoruesin e linjes me qera

Elemente kryesore ne ofrimin e linjave me qera jane gjeresia e brezit, distanca dhe vendodhja e pikave qe do lidhen. Gjeresia e brezit te linjes me qera perben kapaciteten e linjes dhe matet ne Kbits apo Mbits, si 64kbits, 2Mbits etj, dhe i referohet sasise se te dhenave qe mund te dergohen nepermejt linjes se dedikuara. Distanca dhe vendodhja e pikave qe lidhen perbejne

element te lidhur me lokalitete qe do lidhen. Sic u permend edhe me siper, mund te ndodhe qe dy lokalitete qe lidhen mund te ndodhen ne zona gjeografike qe mbuloohen me rrjet nga operatore te ndryshem, dhe ne kete rast ofrimi i linjes se dedikuar behet i mundur nga lidhja e rrjeteve te operatoreve te ndryshem. Elementet e gjerese se brezit dhe largese/gjatesise se linjave me qera, reflektohen ne tarifat e linjave me qera.

Ofrimi i sherbimeve te linjave me qera perben ofrimin e lidhjeve dhe kapaciteve te dedikuara nga vendodhje fikse dhe kane lidhje dhe me sherbimet e tjera te ofruara nga vendodhje fikse. P.sh linjat e dedikuara mund te perdoren per ofrimin e Internetit dhe mund te zevendesojne aksesin ne qarkun lokal. Kapacitetet trunk mund te sherbejne per zevendesimin e tranzitimit te thirrjeve, per operatoret qe ofrojne thirrje telefonike.

### **Ofruesit e linjave me qera**


Ofrimi i linjave me qera mund te kryhet nga cdo operator rrjeti i cili zoteron kapacitete transmetuese njekohesisht investon ne linja per te lidhur perdorues fundore me rrjetin e transmetimit. Operatoret rrjeteve fikse zoterojne kapacitete transmetimi dhe njekohesisht linja fundore, dhe kane te mundur ofrimin e linjave me qera bazuar ne rrjetin lokal dhe backbone te tyre. Nderkohe operatoret e rrjeteve celulare, nuk kane linja fundore por mund te bejne lidhjen fizike sipas kerkesave te perdoruesve.

Ofrimi i linjave me qera per cdo operator varet nga mbulimi territorial me rrjet. Albtelecom dhe operatoret celulare kane mbulim kombetar me rrjet, dhe kane operuar me licensa te Klasit te I, apo kombetare deri ne zevendesimine tyre me Autorizime individuale dhe te pergjithshme. Operatoret Alternative kane kryesisht mbulim rajonale, dhe deri ne hyrjen ne fuqi te Ligjit 9918, dhe zvendesimin e sistemit te licensimit me autorizime kane pasur kufizime territoriale per ofrimin e sherbimeve te yre, perfshire ofrimin e linjave me qera, qe ka qene pjese e te drejtave te licensave te zoteruara prej tyre.

Operatoret Albtelekom, Vodafone Albania, AMC me gjithë prezencen kombetare me rrjet, ndryshojne nga njeri tjetri ne ofrimin e sherbimit te linjave me qera.

Vodafone Albania ka te ngritur rrjetin e linjave me qera duke shfrytezuar kapacitetet e lira te rrjetit te tyre te transmetimit ne funksion te sherbimit te telefonise se levizshme duke perdorur sistemet e lidhjeve fikse pike – pike ose edhe lidhje kablore per rastet kur klienti i rrjetit te tyre eshte gjeografikisht afer. Kurse linjat nderkombetare kane per destinacion Greqine duke perdorur lidhjet radio rele fikse pike-pike per te mundesuar kete sherbim. Vodafone ne pergjigjen perpyetjet e pyetsorit te AKEP, per analizen e tregut te linjave me qera, ka dhene edhe nje skeme (Skema III.3) ku shpjegon menyren e ofrimin te linjave me qera nga rrjeti i Vodafone Albania. Per ofrimin e sherbimit te linjave me qera, investimi i Vodafone Albania perqendrohet ne backbone si dhe ne pjesen fundore 'Last mile' per realizimin e terminimeve lokale

### **SKEMA III.3: RJET FIKS INKUMBENT DHE ALTERNATIV**



AMC është prezent në tregun e linjave me qera në një nivel të kufizuar dhe ka për destinacion Greqinë duke përdorur lidhje mikrovalore të teknologjive SDH dhe PDH me kapacitet deri në 16 E1. Infrastruktura e ngritur përdoret kryesisht në funksion të telefonisë së lëvizshme për shërbimin e transmetimit të të dhënave, shërbimin e interkoneksionit me Cosmote Group. Gjithsesi një pjesë të kapacitetit të saj AMC e ka të kontraktuar në tregun ndërkombëtar (Greqi) me kompaninë OTEGLOBE.

## Albtelecom

Operatori Albtelekom ka prezencë të trashëguar në këtë treg si operator incumbent dhe shtrirja e tij në këtë treg është në dy seksionet (kombëtar dhe ndërkombëtar). Në seksionin kombëtar Albtelekom e ofron këtë shërbim nëpërmjet sistemit të tij të transmetimit pothuajse në shtrirje të plote gjeografike në të gjithë territorin e vendit dhe kryesisht transmetimi realizohet nëpërmjet:

- a) Fiber Optike
- b) Sistem Radio-Rele sipas teknologjive PDH dhe SDH

Rrjeti i transmetimit me Fiber Optike mbulon kryesisht pjesën perëndimore të vendit duke filluar nga Shkodra në Veri deri në Vlorë në Jug si dhe në pjesën Juglindore deri në qytetin e Korçës.

Pjesa tjetër e territorit të vendit mbulohet nga sistemi Radio-Rele duke shfrytëzuar teknologjinë SDH dhe PDH.

Në seksionin ndërkombëtar Albtelekom interkonektohet duke përdorur linja direkte me fiber optike si dhe duke mundësuar trunk segmente si:

Durrës-Bari (Itali), Durrës-Dubrovnik (Kroaci), Durrës-Korfu (Greqi), Shkoder-Podgorice (Mali Zi), Pogradec-Oher (Maqedoni)

Ne seksionin nderkombetar Albtelekom transmeton duke perdorur edhe sistemin Radio-Rele dhe duke ndertuar trunk segment Mide-Cvidhen (Kosove). Pervet transmetimit te pershkruar me siper Albtelekom perdor edhe linja analoge 4 filleshe te cilat vitet e fundit kane tendence rnie.

Operatoret Alternative kane kryesisht mbulim rajonale, dhe deri ne hyrjen ne fuqi te Ligjit 9918, dhe zvendesimin e sistemit te licensimit me autorizime kane pasur kufizime territoriale per ofrimin e sherbimeve te tyre, perfshire ofrimin e linjave me qera, qe ka qene pjese e te drejtave te licensave te zoteruara prej tyre. Efektet liberalizuese te Ligjit 9918, kane sjelle ne invetsime te operatoreve alternative ne zonat me urbane duke rritur zonat e mbulimit te tyre. Nga te dhenat e mbledhur nga operatoret rezulton se vetm nje numer i kufizuar operatoresh alternative, ofrojne linja me qera, nder te cilet spikat ASC, i cili ofron linja me qera bazuar ne lidhje satelitore dhe fiber optike.

Bleresit e linjave me qera jane kryesisht kompanite e medha, ku spikasin bankat, Institucionet Shteterore (Ministrite), si edhe kompanite e telekomunikacioneve.

Aktualisht, rezulton se koncepti i shitjes se linjave me qera me shumice nuk eshte i zhvilluar ne Shqiperi, pasi te gjithe operatoret, ne pyetsoret e plotesuar, deklaruan se nuk ofrojne linja me qera me shumice, pervet AMC e cila ve ne dispozicion te Cosmote, pjese trunk te rrjetit te vet. Nderkohe, Albtelecom, ne ofrimin e linjave me qera nderkombetare ben dallimin midis llojeve te perdorueve, ne perdorues per tranmetim te dhenash dhe kompani telekomunikacioni, duke aplikuar edhe tarifa te ndryshme per keto dy kategori: tarifa me te larta per kompanite e telekomunikacioneve.

## **IV. ANALIZE E TREGUT ME PAKICE TE LINJAVE ME QERA: SETI MINIMUM**

### **IV.1.Perkufizimi i tregut me pakice te linjave me qera**

Ne rregullore, tregu me pakice i linjave me qera, tregu nr.7, eshte perkufizuar si:

- Tregu me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara te linjave me qira deri ne dhe perfshire 2Mb/sek)

Ky perkufizim eshte i njejte me perkufizimin e dhene ne rekomandimin e KE te vitit 2003 per tregjet perkates. Ne perputhje me piken 3 te nenit 3 te Rregullores, ne kete seksion analizohet dimensionimi i produkteve/sherbimeve dhe dimensionimi gjeografik i tregut me pakice te linjave me qera, per te percaktuar sherbimet te cilat jane pjese e te njejtin treg perkates.

#### **I. Dimensionimi i produkteve/sherbimeve te tregut me pakice te linjave me qera**

Disa nga ceshtjet per tu trajtuar ne sherbimet qe bejne pjese ne te njejtin treg perkates me pakice te linjave me qera jane:

1. linjat me qera te kapaciteteve te ndryshme
2. linjat me qera analoge dhe dixitale
3. linjat me qera kombetare dhe nderkombetare
4. linjat me qera tradicionale dhe sherbimet e menaxhuara apo tranmetimi i te dhenave

##### **1. Linjat me qera te kapaciteteve te ndryshme**

Linjat me qera ofrohen ne kapacitete 64kbps dhe shumefisha te tij si 128 kbps dhe 2048kbps, 34 MBps dhe 155 mbps. Kapaciteti i kerkuar nga bleresi varet nga sasia e trafikut apo te dhenave qe dergohen apo pritet te dregohen nepermjet linjes me qera. Bleresit per te realizuar kerkesat e tyre mund te blejne edhe disa linja me kapacitete te njejte. Per te analizuar zevendesueshmerine nga bleresit (kerkesa) per linja me qera te kapaciteteve te ndryshme eshte e nevojshme te analizohet nese bleresit do te ishin te gatshem qe ne rast te rritjes se cmimit me 5-10% te nje linje me kapacitete te caktuar X, te zevendesonin kete linje me qera me disa linja me kapacitet me te vogel Y apo e anasjellta, te zevendesonin disa linja me kapacitet Y me nje linje me kapacitet me te madh X, ne rast te rritjes se cmimit te linjes me kapacitet Y.

AKEP gjykon se, nga ana funksionale, zevendesimi i disa linjave me kapacitet te ulet me nje apo disa linja me kapacitet me te larte, apo e anasjellta, megjithese eshte i mundshem, ka kufizime. Kufizimet mund te vijne ne zevendesimin e nje linje me kapacitete te larte me shume linja me kapacitet te ulet, pasi linjat me kapacitet te ulet mund te mos sigurojne ofrimin e aplikimeve qe mund et sigurohen ne linja me kapacitet te larte. Keto kufizime jane me te ndjeshme per linjat me qera me diferenca te medha ne kapacitete si linjat mbi 2 Mbits dhe linjat e setit minimal, deri ne dhe perfshire 2 mbits. Sherbimet e linjave me kapacitete te

peraferta, linjat 64kbits-2mbits, mund te konsiderohen zevendesuese me njera tjetren, por jo me linjat me kapacitet te larta mbi 2mbits, si 34mbits, 155mbits etj. Nje ndryshim i renewsishem midis linjave me kapacite te larte dhe ato me kapacitet te ulet eshte tekologjia e perdorur per ofrimin e ture: linjat me kapacitet te larte zakonisht ofrohen nepermjet fibrave optike, ndersa linjat me kapacitet te ulet ofrohen epermjet linjave te bakrit apo lidhjeve me radiofrekuenca. Keto ndryshime ne teknologji sjellin dhe ndryshime ne menyren e tarifimit dhe nivelin e tarifave te aplikuar.

Per sa i perket gatishmerise se blesesve per zevendesim ne terma te cmimit, ky zevendesim duhet pare ne cmimet respektive te linjave me qera me kapacitete te ndryshme. Nga tabela e cmimeve te linjave me qera te Albtelcom per kapacitet 64kbits dhe 2 mbits vihet re cmimet per 2 Mbs jane nga 40-50% (deri ne 25km dhe mbi 100km) deri ne 100-250% (25-100 km) me te larta se per qarqet 64kbits,. Nderkohe kapaciteti i nje lije 2Mbts eshte 32 here me i madh se i linjes 64kbits.

Krahasim i cmimeve per linjat me qera te kapaciteteve te ndryshme te Albtelcom

4. Qarqe dixhitale KOMBETARE me qera		
Shpejtesia e transmetimit	Tarifa pajtimit mujor	Tarifa e instalimit
	LEK/ MUAJ	LEK
	deri ne 25 Km	
64 Kbit/s	20.000	20.000
2 Mbit/s	28000	
	25-50 Km	
64 Kbit/s	30.000	30.000
2 Mbit/s	60.000	
	50-100 Km	
64 Kbit/s	40.000	50.000
2 Mbit/s	100.000	
	mbi 100 Km	
64 Kbit/s	80.000	60.000
2 Mbit/s	120.000	

*Shenim: Tarifat jane pa TVSH*

Nga ky raport cmimesh eshte e qarte se zevendesimi i shume (32) linjave 64kbits per nje lije 2mbts, eshte teper i favorshem, madje edhe zevendesimi i 2 apo 3 linjave. E anasjellta

zevendesimi i nje linje 2mbits per 32 linja 64 kbts nuk ben sens ne raportet aktuale te cmimeve pasi eshte shume e shtrenjte.

Megjithate, eshte e nevojshme te theksojme se krahasimi i cmimeve per te vleresuar zevendesueshmerine duhet bere bazuar ne cmime konkurruese te produkteve dhe ne cmime jo-konkurruese. Sic do te verejme ne seksionin e analizes se tarifave, tarifat e Albtelecom per linjat me qera kane disporporcion shume te madh me tarifat ne vendet e rajonit dhe te BE: linjat 64 kbts ajne shume me te larta ndersa linjat 2mbits kane cmime shume me te uleta se tarifat ne vendet e tjera, dhe nuk mund te thuhet se tarifat jane te ngjashme me tarifat qe do te ishin ne nje treg konkurrues te linjave me qera.

Bazuar edhe ne rekomandimet e BE, si dhe ne pervojen rregullatore te vendeve te tjera, AKEP gjykon se:

- linjat me qera me kapacitet te ulet (deri ne dhe perfshire 2mbits) jane pjese e te njejtit treg perkates;
- linjat me qera me kapacitet te larte (mbi 2mbits), nuk jane pjese e tregut perkates te linjave me qera me kapacitet te ulet.

Kjo ndarje e linjave, behet akoma me e nevojshme ne kushte aktuale te tregut ne Shqiperi, ku ofrimi i linjave me qera me kapacitet te larte, eshte nje praktike e rralle.

## **2. Linjat me qera analoge dhe dixitale**

Ne tregun me pakice te linjave me qera jane prezente si linjat analoge dhe ato digitale. Linjat analoge perdoren kryesisht per kapacite te uleta, dhe per keto linja diferenca funksionale midis linjave meqera dixhitale dhe analoge nuk eshte e madhe, pasi te dy llojet e linjave supotojne transmetimin e sinjaleve zanore dhe te dhenave si dhe ofrohen me te njejtin mjet fizik (linja bakri apo frekuenca??), duke ndryshar vetem ne pajisjet fundore te rrjetit te perdorur ne te dy skajet e linjave me qera. Ne kete menyre linjat me qera dixitale dhe analoge mund te konsiderohen si zevendesues si per bleresit dhe per ofruesit e tyre.

Per sa me siper, AKEP gjykon se per linjat me qera me kapacite te ulet, linjat analoge dhe linjat dixhitale jane pjese e te njejtit treg perkates.

## **3. Linjat me qera kombetare dhe nderkombetare**

Zevendesueshmeria e linjave me qera kombetare dhe nderkombetare eshte e veshtire dhe parktikisht e pamundur si nga ana e kerkese dhe ofertes. Nje klient qe kerkon linje me qera kombetare nuk mund ta zevndesoje ate me nje linje me qera nderkombetare, dhe e anasjellta, pasi ndrsyrimi themelor midis ketyre linjave eshte vendodhja e pikave fundore: linjate me qera kombetare kane te dy pikat fundore ne territorin e shqiperise, ndersa linjat meqera nderkombetare kane vetem nje pike fundore ne Shqiperi dhe pika tjetere jashte Shqiperise. Gjithashtu ofrimi i linjave me qera nderkombetare behet i mundur nga marredheniet dhe lidhjet me infrastrukturen e rrjeteve te operatoreve jshte Shqiperise, ndersa ofrimi i linjave me qera kombetare mund te kryhet bazuar ne infrastrukturen e nje operatori apo te disa operatoreve ne Shqiperi. Gjithashtu kushtet e konkurrences se ketyre tregjeve jane te ndryshem.

Ofrimi i linjave me qera nderkombetare, permбан:

- Pjesen e infrastruktures se rrjetit ne Shqiperi:
  - i. nje pike fundore (A) te linjes me qera ne Shqiperi
  - ii. segmenti pike fundore ne Shqiperi-piken e interkoneksionit (lidhjes) se operatorit vendas me rrjetin nderkombetar,
- Infrastruktura jashte Shqiperise:
  - i. segmenti pike e interkoneksionit (lidhjes) se operatorit vendas me rrjetin nderkombetar-pika fundore e linjes jashte Shqipersi
  - ii. pika fundore (B) ne nje shtet tjetër

Ofrimi nga operatori vendas i pjeses se infrastruktures brenda vendit, nuk ka ndryshime nga ofrimi i ketij segmenti per linje me qera kombetare, pervec se kjo pjese e linjes nderkombetare lidhet me centralin nderkombetare apo piken e interkoneksionit me operatorin nderkombetar. Ofrimi nga operatoret vendas i kesaj pjese te linjes nderkombetare, megjithese nuk eshte e gjithë linja nderkombetare, nuk paraqet ndryshime thelbesore nga ofrimi i linjave me qera kombetare.

Linja me qera nderkombetare ofrohet nga operatori vendas, dhe klienti paguan operatorin vendas per detyrimin qe ka ndaj tij (pjesa e infrastruktures se tij) dhe per detyrimin ndaj operatorit te huaj, qe realizon ofrimin e pjeses tjetër te infrastruktures.

Ofrimi i pjeses kombetare te linjes me qera me pakice nderkombetare, konsiderohet pjese e tregjeve me pakice te linjave me qera.

#### **4. Linjat tradicionale me qera dhe sherbimet e menaxhuara**

Rekomandimi i KE per tregjet perkates pershkruan linjat me qera duke iu referuar kapaciteteve dhe lidhjeve te dedikuara, d.m.th. linjave tradicionale me qera. Nderkohe kapacitetet pike me pike mund te jene te disponueshme edhe nepermjet sherbimeve te menaxhuara te cilat jo domodoshmerisht jane kapacitete te dedikuara, por mund te ofrojne sherbime me funksione te ngjashme apo te njejta me linjat tradicionale me qera. Ligji 9918 ne perkufizimin e linjave me qera nuk percakton nese kapacitetet transmetuese jane te dedikuara apo jo.

Sherbimet e menaxhuara te cilat mund te ofrojne sherbime me funksione te ngjashme apo te njejta me linjat me qera jane:

- i. ATM VPN
- ii. IP VPN
- iii. Frame Relay
- iv. Ethernet
- v. Symmetric Digital Subscriber Line (SDSL)
- vi. Aksesit ne Internet nepermjet kapacitetit asimetric broadband

Keto sherbime zakonisht perdoren per kapacitete te larta dhe ne rastin e sherbimeve te linjave me qera te setit minimum qe perfshin linjat me qera deri ne dhe perfshire 2 Mbit/s, sherbimet e menaxhuara te cituara me lart, mund te konsiderohen pjese e tregjeve te linjave me qera te kapaciteteve te larta, por nuk mund te konsiderohen te jene pjese e te njejtit treg me pakice, te linjave me qera te setit minimal. Meqenese objekti kesaj analize jane linjat me qera me

kapacitet te ulet, deri ne dhe perfshire 2Mbit/s, keto sherbime nuk jane pjese e kesaj analize te AKEP.

AKEP gjykon se sherbimet e menaxhuara nuk jane pjese e te tjetit treg perkates me pakice te setit minimal te linjave me qera me kapacitet deri ne dhe perfshire 2mbits.

## **II. Dimensioni gjeografik i tregut**

Ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, Udhezimi i KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojne midis te tjerave se dimensionin gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Albtelecom dhe operatoret e rrjeteve celulare ne baze te licensave individuale te Klases 1, te zevendesuar me autorizime individuale dhe te pergjithshme, ofrojne sherbimet e tyre ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Nderkohe operatoret alternative te rrjeteve fikse, ne baze te sistemit te autorizimeve et pergjithshme, megjithese kane mbulim te kufizuar territorial ne disa zona, nuk kane kufizime ne zonen e mbulimit me rrjet. Ne kete menyre mund te konkludojme se:

*Dimensioni gjeografik i sherbimit te linjave me qera eshte kombetar, d.m.th territori i Republikes se Shqiperise.*

Per sa me me siper, percaktimi i tregut me pakice te linjave me qera eshte:

- **Tregu i setit minimum te linjave me qera, perfshin linjat me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek, analoge dhe dixhtale;**
- **Dimensioni gjeografik i tregut eshte kombetar**

## IV.2 Analiza per Fuqi te Ndjeshme ne Tregun me pakice

Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate, dhe midis te tjerave citon:

*2. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:*

*a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;*

*b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;*

*c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;*

*ç) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;*

*d) në fazën e tregut përkatës;*

*dh) në përparësitë teknologjike;*

*e) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;*

*ë) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;*

*f) në shkallën e integritit vertikal;*

*g) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;*

*gj) në aksesin në burimet financiare;*

*h) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;*

*i) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifatat, paketat e shërbimeve dhe të produkteve ose vendosjen e pengesave.*

Lista e kriterëve nuk është liste kumulative apo përjashtuese e kriterëve/karakteristikave të tjera për dominancë apo FNT.

### I. Pjesët e tregut

AKEP, me qëllim kryerjen e një analize tregu për linjat me qera sa më të plote, me datë 24.12.2008 ka kërkuar nga operatorët e rrjeteve informacion në lidhje me ofrimin e tyre të linjave me qera, duke mbuluar aspektet e numrit të linjave me qera të dhëna, të detajuara sipas gjërësise, distancës dhe kombëtare/nderkombëtare si dhe tarifatat dhe të ardhurat për linjat me qera. Për shkak të cilesisë së dobët të të dhënave, AKEP me datë 16.06.2009, publikoi një pyetsor me të plote për linjat me qera, duke përfshirë jo vetëm ofrimin por edhe marrjen/blerjen e linjave me qera, si dhe kërkoi nga operatorët të jepnin komentet e tyre për disa çështje që jave pjesë e analizës, në lidhje me konkurrencën në tregjet me pakice dhe me shumicë, segmentimin e tregjeve me shumicë dhe me pakice. Ne vijim paraqitet një informacion i përmbledhur për ofrimin e linjave me qera nga operatorët në Shqipëri.

Nga të dhënat e dërguara nga operatorët rezultojnë se:

- Linjat me qera ofrohen me kapacitete deri në 2mbits ose shumëfisha të tyre, por jo me kapacitete më të larta se 2mbits (përveç ofrimit nga ASC të linjave me kapacitete 10mbps);

Nga te dhenat e raportuara nga Albelecom ne menyre periodike, rezulton se numri i linjave me qera te ofruara nga Albelecom eshet shume me i madh se numri i deklaruar nepermjet pyetsorit te derguar per kete Analize Tregu (shiko tabelen IV.1)

**Tabela IV.1 Numri i Linjave me qera te Albelecom: raportim periodik dhe per Analizen**


	2006	2007	2008
<b>Te dhena periodike</b>	464	727	759
<b>Te dhena per Analizen</b>	71	78	213

**Tabela IV.2 Numri i Linjave me qera: raportim i operatoreve per Analizen**

	2006	2007	2008
<b>Albelecom</b>	71	78	213
<b>Operator 1</b>	7	9	9
<b>Operator 2</b>	51	69	118
<b>Operator 3</b>		1	2
<b>Operator 4</b>		28	41
<b>Total</b>	129	185	383

Bazuar ne te dhenat e deklaruar te operatoreve, ne figuren e meposhteme paraqiten pjeset e tregut te Albelecom, per numrin e linjave me qera (sipas te dhenave periodike dhe per Analizen) dhe per te ardhurat e marra nga Linjat me qera. Pjeset e tregut te operatoreve te tjere per vitin 2008 variojne nga zero deri ne 31% per numrin e linjave me qera (sipas pyetsoreve) dhe zero deri ne 25% per te ardhurat. Nga te dhenat e pjeseve te tregut vihet re se Albelecom zoteron mbi 50% pjese tregu ne numrin e linjave me qera dhe te ardhurave prej tyre, ndersa operatori me i afert zoteron vetem 25-30% pjese tregu.

**Figura IV.1 Pjeset e Tregut te Albelecom: numri dhe te ardhurat per linjat me qera**



Sipas te dhenave te mesiperme, Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 50%<sup>5</sup> te linjave me qera, per numrin e linjave me qera dhe per te ardhurat. Keto nivele megjithese kane ardhur ne renie ne vitin 2007, kane pesuar rritje perseri ne vitin 2008. Ne Udhezimin e BE, shprehet qarte se pjesa e tregut me e madhe se 50 per qind eshte nje tregues i padiskutueshem i fuqise se ndjeshme ne treg dhe, vetem ne raste te rralla mund te ndodhe qe nje operator me pjese tregu te tille te mos kete fuqi te ndjeshme ne treg<sup>6</sup>.

Gjithashtu nje percaktim i rendesishem i nenit 33 per FNT, te Ligjit 9918, eshte pika 5:

*5. Kur një sipërmarrës ka fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ai vlerësohet se mund të ketë fuqi të ndjeshme në treg edhe në një treg përkatës tjetër, të lidhur horizontalisht, vertikalisht ose gjeografikisht me tregun e analizuar, nëse lidhjet ndërmjet dy tregjeve janë të tilla që mundësojnë shtrirjen e fuqisë së ndjeshme nga tregu i parë në tjetrin, duke fuqizuar kështu fuqinë e sipërmarrësit në treg.*

Sic u theksua ne seksionet e meparshem, Operatoret rrjeteve fikse zoterojne kapacitete transmetimi dhe njekohesisht linja fundore, dhe kane te mundur ofrimin e linjave me qera bazuar ne rrjetin lokal dhe backbone te tyre. Operatori Albtelekom ka prezenca te trasheguar ne rrjetin lokal dhe backobone (si dhe vazhdon investimet ne keto rrjete).

<sup>5</sup> Pjesa e tregut te Albtelecom sipas te dhenave periodike te Albtelecom eshte shume me e madhe, ne nivele mbi 80%. Ketu e ne vijim do ti referohemi pjese se tregut te Albtelecom sipas te dhenave te depozituar per Anlizen, e cila megjithese ka ndryshim te madh nga te dhenat periodike nuk ndikon ne perfundimet e AKEP. Sqarimi i kontradites ne te dhena do te kryhet gjate periudhes se konsultimit publik.

<sup>6</sup> According to established case-law, very large market shares — in excess of 50 % — are in themselves, save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position (78). An undertaking with a large market share may be presumed to have SMP, that is, to be in a dominant position, if its market share has remained stable over time.

Albtelecom është aktualisht operator me FNT në tregun me pakice të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe është propozuar në dokumentin për konsultim publik, “Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakice të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetë fikse: Konsultim Publik”, publikuar nga AKEP më 17.09.2009, si operator me FNT në këtë treg. Sipas të dhënave të Tabeles III.1 (dokumenti i Analizës së cituar), Albtelecom zoteron pjesë tregu në nivele mbi 80% të pajtimtareve (aksesit), dhe mbi 90% për të ardhurat. Prezenca kombëtare e Albtelecom në rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT në këtë treg, është faktor që konsiderohet i rëndësishëm për të shtrirë FNT në tregun me pakice (dhe me shumicë të segmenteve terminuese-lokale) të linjave me qera.

## **II. Pengesat për hyrje dhe Konkurrencë e mundshme në tregun e linjave me qera**

Pjesa e madhe e tregut e një operatori mund të mos jetë tregues i fuqisë së ndjeshme në treg, në rast se nuk plotësohen një sërë kushtesh të tjera. Një ndër këto kushte është edhe ekzistenca e barrierave në treg. Nëse një operator ka pjesë të madhe në treg, por ndërkohe tregu është i hapur ndaj operatorëve të rinj, të cilët mund të hyjnë dhe dalin nga tregu pa kufizime ligjore dhe kosto ekonomike, atëherë aftësia e një operatori me pjesë të madhe tregu për të ndikuar në këtë treg është e kufizuar.

### **Pengesa ligjore**

Sic është theksuar edhe në seksionet e tjera, për ofrimin e linjave me qera nuk ka pasur pengesa ligjore për operatorët alternativë dhe operatorët celularë, përveç kufizimit të zonës së aktivitetit të operatorëve alternativë (me parë rurale) vetëm në zona rurale dhe me vone në disa rajone. Ndryshimi kryesor në lidhje me pengesat për hyrjen në treg, është liberalizmi i tregut dhe lehtësimi i procedurave për sipermarresit në sektorin e komunikimeve elektronike, që solli hyrja në fuqi më 26.06.2008 e Ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe kuadrit rregullator të tij, veçanërisht sistemi i autorizimeve të pergjithshme. Hyrja në fuqi e këtij Ligji ka hequr pengesat ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike në shkallë kombëtare që ekzistonin në Ligjin e mëparshëm 8618. Për sektorin e telefonisë fikse dhe ofrimin e linjave me qera nuk ekzistojnë më pengesa ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve fikse në shkallë kombëtare përfshirë zonat urbane.

***Zevendesimi i sistemit të komplikuar të licensimit me licensa të klasave të ndryshme dhe për zona operimi të paraktuara me sistemin e autorizimit të pergjithshëm përben një eliminim apo reduktim të ndjeshëm të pengesave ligjore në ofrimin e linjave me qera me pakice.***

Megjithatë këto ndryshime ligjore, në ofrimin e linjave me qera me pakice ekzistojnë pengesa strukturore. AKEP gjykon se konkurrencë e mundshme nga operatorët aktualë dhe të rinj për një periudhë afatmesme nuk do të jetë e mjaftueshme për të kufizuar apo eliminuar aftësinë ndikuese në treg të Albtelecom, për arsye se Albtelecom zoteron disa avantazhe ndaj operatorëve aktualë dhe të mundshëm të cilat do të vazhdojnë t’i këtë edhe në një periudhë

afatmesme. Nder keto avantazhe te Albtelecom, apo pengesa strukturore te tregut linjave me qera, mund te permendim avantazhet qe vijne si operator rrjeti kombetar te telefonise fikse (rrjet lokal dhe backbone)<sup>7</sup>:

### **Ekonomite e shkalles**

Ekonomite e shkalles perfitohen kur kostoja per njesi e sherbimit zvogelohet me rritjen e sasise se sherbimit. Ne ofrimin e sherbimeve te telekomunikacioneve, ekonomite e shkalles jane te konsiderueshme, dhe kjo perben nje pengese per operatore te rinj per te konkurruar me nje operator me rrjet te shtrire ne te gjithë territorin e nje vendi. Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me operatoret alternative dhe celulare dhe operatore te rinj te mundshem ne treg, per ofrimin e linjave lokale te telefonise fikse dhe ne kete menyre edhe per ofrimin e linjave me qera.

Albtelekom duke patur nje rrjet infrastrukturor backbone edhe ne tregun e linjave me qera trasheron nje status te tille (perfshire edhe setin minimum te linjave me qera me kapacitet deri ne 2 Mbit/s). Dimensioni i shtrirjes se rrjetit perben nje pozicion dominant ne raport me sipermarres te tjere ne kete treg. Vodafone Albania dhe AMC qe sipas te dhenave te servitura per kete analize kane te ngritur nje infrastrukture duke shfrytëzuar kapacitetet e lira te rrjetit te transmetimit, serish teknologjia e transmetimit eshte e mbeshetur sistemin e lidhjeve radio-rele dhe vetem per distanca te vogla me lidhje kabllore kryesisht kur perdoruesi fundor eshte gjeografikisht afer dhe mundesohet aksesimi per te. Ne ndryshim nga kjo, Albtelekom ka prezence me nje infrastrukture me kapacitet ne shtrirje gjeografike si dhe me kualitet me te larte dhe ne ofrimin e ketij sherbimi dhe si rrjedhoje kjo perben nje avantazh te Albtelekom ne raport me ofruesit e tjere te linjave me qera ne tregun e pakices pjese e te cilit eshte edhe seti minimum i linjave me qera.

### **Ekonomite e densitetit**

Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendese) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh ne ofrimin e linjave me qera. Albtelecom ka qene i vetmi operator rrjeti i lejuar te ndertoje rrjet ne zonat urbane te cilat jane zona me dendesi shume me te madhe se zonat rurale. Me liberalizimin e tregut ne zonat urbane kete avantazh do ta kene edhe operatoret qe investojne ne keto zona ne krahasim me operatoret ne zonat rurale.

### **Lojtari i pare ne Treg**

Albtelecom zoteron gjithashtu avantazhin e lojtarit te pare ne treg (first mover advantage). Albtelecom, megjithese me nje numer te vogel te perdoruesve, eshte prezent me infrastrukture ne te gjitha zonat urbane, dhe ne krahasim me nje operator te ri ka avantazh. Kjo prezence i jep mundesine qe te kete kosto me te uleta per te zgjeruar rrjetin ne keto zona dhe ofrimin e linjave me qera, ne krahasim me operatore te rinj qe duhet te fillojne investimet nisur nga niveli zero i perdoruesve dhe infrastrukture nga fillimi.

### **Integrimi vertikal**

---

<sup>7</sup> Avantazhe te permendura edhe ne Analize 2007 dhe 2009 te telefonise fikse.

Prezenca e nje operatori ne dy nivele te tregjeve, me shumice dhe me pakice, d.m.th. integrimi vertikal rrit aftesine ndikuese ne treg te operatorit. Operatoret e rrjeteve telefonike publike jane vertikalisht te integruar. Avantazhet e krijuara nga madhesia e rrjetit (niveli me shumice), prezenca me linja abonentesh ne te gjitha rrethet e RSH (niveli me pakice) te operatorit Albtelecom jane shume me te medha se ato te operatoreve te tjere (rurale) dhe operatoreve te rinj te mundshem ne treg. Nje operator vertikalisht i integruar, ka mundesine qe te krijojte avantazhe (diskriminoje) per pjesen e tij te ofrimit te sherbimeve ne nivelin me pakice ndaj konkurrenteve te tjere per keto tregje perkatese me pakice, duke perdorur aftesine ndikuese ne nivelin (tregjet) me shumice, pra duke ofruar sherbimet (inpute per tregjet me pakice) ne nivelin me shumice konkurrenteve te tij me cmime me te larta se ai ofron per pjesen e vet retail (kjo ceshtje trajtohet me gjere ne pjesen e tregjeve me shumice).

Avantazhet e mesiperme te Albtelecom, perforcohen edhe nga kufizimet e operatoreve alternative dhe operatoreve celulare per te konkurruar albtelecom ne ofrimin e linjave me qera:

- Mbulimi i kufizuar territorial nga operatoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem em Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar linja me qera apo lidhje te dedikuara ne zona te ndryshme gjeografike.
- Mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare: operatoret celulare kane rrjet kombetar backbone mikrovalor qe e shfrytezojne kryesisht per rrjetet GSM, por mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare, perben disavantazh per keta operatore per ofrimin e linjave me qera, pasi do te duhet et ndertojne rast pas rasti keto lidhje lokale (nderkohe qe Albtelecom ne me te shumten e rasteve i ka te gatshme).

Aftesia e konkurrences se mundshme ne kete treg, ne fiormen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurrues ete operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me albtelecom ne ofrimin e linjave me qera, eshte i madh.

Aktulisht, USAID eshte ne proces te nje studimi feasibilitetit, per ndertimin e nje rrjeti backbone me fiber optike, i cili do te mbuloje te gjitha Shqiperine. Ndertimi dhe funksionimi i ketij rrjeti backbone, pritet te kete nje efekt pozitiv edhe ne konkurrencen per dhenien e linjave me qera. Megjithate, ky projekt eshte ende ne faze studimi dhe implementimi i plote tij, nuk gjykohet se do te perfundoje brenda nje afati dy vjecar te kesaj analize tregu.

***Megjithe eliminimin apo reduktimin e ndjeshem te pengesave ligjore, qe erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator te autorizimeve te pergjithshme, Albtelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere per shkak te ekonomive te shkalles, ekonomive te densitetit, integrimit vertikal. Keto avantazhe te Albtelecom, ne rrjetin lokal dhe backbone, ndikojne pozitivisht ne aftesine ndikuese te Albtelecom ne tregjet me pakice te linjave me qera.***

### III. Fuqia kundervepruese e bleresve te linjave me qera

Pozita e nje operatori, qe eshte dominant ne ofrimin e nje sherbimi, mund te jete me e dobet nese ekzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht, i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit te shitesit per te mos humbur kete klient. Bleresit me pakice te linjave me qera jane kompani apo institucione te cilat kane nevojte te lidhin ambiente te ndryshme nepermjet kapaciteteve te dedikuara. Ofrimi i linjave me qera eshte i varur nga vendodhja e ambienteve qe do lidhen, dhe avantazhet e Albtelecom te lidhur me prezencen me rrjet n nivel kombetar, ulin aftesine negociuese te bleresve, pasi Albtelecom shpesh eshte i vetmi operator qe mund te siguroje sherbimin e kerkuar nga bleresi.

### IV. Tarifimi i linjave me qera me pakice

Ne Aneks 1, paraqiten tarifat e aplikuar nga Albtelecom per te gjitha llojet e linjave e me qera. Tarifimi i linjave me qera kryhet ne baze te kapacitetit apo shpejtesise se transmetimit dhe gjatesise se linjes. Tarifa te vecanta aplikohen per linjat ne rrjetin urban dhe sistem Fiber optike. Tarifat permbajne pagese fikse, tarife instalimi e cila paguhet vetem nje here, dhe tarifa periodike mujore. Tarifat per Linjat me qera nderkombetare perfshijne segmentin nderkombetar shqiptar, qarkun kombetar dhe qarkun lokal, duke bere dallimin ne llojin e bleresit: bleres kompani telekomunikacioni dhe per transmetim te dhenash. Tarifat e linjave me qera jane te ndara ne qarqe dixhitale dhe analoge.

Ne tabelat dhe figurat e meposhteme paraqiten tarifat e Albtelecom, Vodafone dhe ASC per linjat me qera kombetare dhe nderkombetare. Ne tabelat IV.3 dhe IV.4 parqitet krahasimi i tarifave te linjave me qera kombetare dhe nderkombetare (64kbits dhe 2mbits), te aplikuar nga Albtelecom dhe Vodafone, pasi ne baze et informacionit te derguar vetem tarifat e ketyre dy operatoreve ishin te krahsueshme. Tarifat e qarqeve nderkombetare te Albtelecom jane te shprehura ne Euro dhe USD, por ne tabelen IV.4, ato jane shprehur ne Lek, duke perdorur Kursin e kembimit te publikuar nga Banka e Shqiperise per daten 5.11.2009.<sup>8</sup> Ne tabele IV.5 jane parqitur tarifat e ASC, te cilat jane perlinja te dedikuara duke perdorur VSAT (64/128 kbits), Fiber optike (10/100 mbits) dhe lidhje wireless.

Tabela IV.3 Krahasimi i tarifave te linjave me qera kombetare: Albtelecom dhe Vodafone

Gjatesia e Linjes	Shpejtesia e transmetimit	Tarifa pajtimit mujor (Lek/Muaj)		Tarifa e instalimit (Lek)	
		Albtelecom	Vodafone	Albtelecom	Vodafone
deri ne 25 Km	64 Kbit/s	20.000	71.420	20.000	85.608
	2 Mbit/s	28.000	86.650		104.796
25-50 Km	64 Kbit/s	30.000	84.910	30.000	123.984
	2 Mbit/s	60.000	95.160		146.124

<sup>8</sup> Euro/Lek 137.68 ; USD/Lek 92.79

50-100 Km	64 Kbit/s	40.000	91.740	50.000	162.360
	2 Mbit/s	100.000	105.050		177.120
mbi 100 Km	64 Kbit/s	80.000	95.940	60.000	
	2 Mbit/s	120.000	110.700		190.404

Tabela IV.4 Krahasimi i tarifave te linjave me qera Nderkombetare: Albtelecom dhe Vodafone

Shpejtesia e transmetimit	Tarifa instalimit			Tarifa pajtimit mujor				
	Albtelecom		Vodafone	Albtelecom		Vodafone		
	Transmetim te dhenash	Kompani Telekomunikacioni		Transmetim te dhenash	Kompani Telekomunikacioni	25-50 km	50-100 km	mbi 100 km
	64 Kbit/s	82.608	89.078		103.260	186.972	488.000	493.000
2 Mbit/s	239.563	290.433		1.343.757	2.160.615	488.000	493.000	492.000

Tabela IV.5 Tarifat e linjave me qera te ASC

Lloji i Linjes me qera	Pagesa Mujore (Euro/Muaj)
Linje e dedikuar VSAT	175
Linje e dedikuar me FO	100
Linje e dedikuar me HFC	50
Linje e dedikuar me wireless	50

Nga krahasimi i tarifave te Albtelecom dhe Vodafone vihet re se:

I- linja me qera kombetare

- Albtelecom ka tarifa shume me te uleta instalimi se Vodafone per te gjitha distancat dhe dy llojet e kapciteteve;
- Albtelecom ka tarifa shume me te ulet se Vodafone per linjat me qera 64kbits per te gjitha distancat dhe per 2 mbits per distanca deri ne 50 km;
- Tarifat e linjave me qera 2mbits te Albtelcom dhe Vodafone, per distanca 50-100 dhe mbi 100 km jane te peraferta;


## II. linja me qera nderkombetare

- Tarifat e pajtimit mujor te linjave te Albtelecom, per te dy llojet e perdoruesve) jane 3-4 here me te larta se tarifat e Vodafone;
- Tarifat e pajtimit mujor dhe te instalimit per kompanite e telekomunikacioneve jane 60-80% me te larta se per klientet e tjere, jo kompani telekomunikacioni.

## Krahasimi i tarifave te Albtelecom me vendet e rajonit dhe BE


Ne vijim parqiten krahasimi i tarifave te linjave me qera te Albtelecom me vendet e rajonit te Europes JugLindore (SEE) dhe te BE. Krahasimi eshte bere per linjat me qera 64kbit/s dhe 2mbit/s, per qarqe kombetare me distanca 2, 50 dhe 200 km, si dhe per linjat nderkombetare drejt vendit fqinj dhe drejt UK. Tarifat i referohen vetem pajtimit mujor dhe jane shprehur ne Euro/vit apo Euro/muaj.

Figure IV.2 Krahasimi i tarifave te linjave me qera Kombetare 64kbit/s: Albtelecom dhe SEE




Burimi: Cullen International” Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries” Report II, 1.06.2009

Figure IV.3 Krahasimi i tarifave te linjave me qera Kombetare 2 Mbit/s: Albtelecom dhe SEE




*Burimi: Cullen International” Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries” Report II, 1.06.2009*

**Figure IV.5 Krahasimi i tarifave te linjave me qera NderKombetare 64kbit/s: Albtelecom dhe SEE**



*Burimi: Cullen International” Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries” Report II, 1.06.2009*

Figure IV. Krahasimi i tarifave te linjave me qera Nderkombetare 2 Mbit/s: Albtelecom dhe SEE



Burimi: "Cullen International" Supply of services in monitoring regulatory and market developments for electronic communications and information society services in Enlargement Countries" Report II, 1.06.2009

Tabele IV.6 Krahasimi i tarifave te linjave me qera : Albtelecom dhe EU (Euro/muaj)

Distanca	Kapaciteti	Albtelecom	EU 27 2007/8	Ndryshimi
2 km	64 Kbit/s	145	166	-12%
	2 Mbit/s	203	587	-65%
50 km	64 Kbit/s	218	340	-36%
	2 Mbit/s	436	1.500	-71%
200 km	64 Kbit/s	581	460	26%
	2 Mbit/s	872	2.591	-66%
Nderkombetare (vend fqinje)	64 Kbit/s	750	736	2%
		1.358		85%
	2 Mbit/s	9.760	10%	
		15.693	8.906	76%

Burimi: Tarifate Albtelecom

European Commission: Progress Report on the Single European Electronic Communications Market 2008 (14th Implementation Report)

Report on Telecoms Price Developments from 1998 to 2007. Prepared by Teligen December 2007, for European Commission, Directorate General for Information Society

Nga krahasimi i tarifave te linjave me qera te Albtelecom me tarifate ne vendet e SEE dhe vendet e BE (te pasqyruar me sipes) rezulton:

- Tarifate e Albtelecom per qarqet kombetare 64 kbit/s:
  - o Per distanca 2 km jane me te lartat ne rajonin SEE,
  - o Per distanca 2 km dhe 50 km jane 12-36% me te uleta se mesatarja e vendeve te BE;
  - o Per distanca 200 km jane 26% me te larta se mesatarja e vendeve te BE;
- Tarifate e Albtelecom per qarqet kombetare 2 Mbit/s:
  - o Per distanca 2 km jane me te uletat ne rajonin SEE,
  - o Per distanca 2, 50 dhe 200 km jane 65-71% me te uleta, apo 2.8-3.4 here me te lira se mesatarja e vendeve te BE,;
- Tarifate e Albtelecom per qarqet nderkombetare 64 kbit/s:
  - o Jane me te lartat e rajonin SEE;
  - o Per kompanite Jo telekomunikacionesh jane 2% me te larta se mesatarja e BE;
  - o Per kompanite telekomunikacionesh jane 85% me te larta se mesatarja e BE
- Tarifate e Albtelecom per qarqet nderkombetare 2 Mbit/s:
  - o Jane me te lartat e rajonin SEE;
  - o Per kompanite Jo telekomunikacionesh jane 10% me te larta se mesatarja e BE;
  - o Per kompanite telekomunikacionesh jane 76% me te larta se mesatarja e BE

Per sa cituar ne kete seksion:

- Tarifate e linjave me qera te Albtelecom kane disporcione te konsiderueshme ne strukturen e tyre:
  - o tarifa shume me te larta per kompanite e telekomunikacioneve se kompanite qe i blejne linjat me qera nderkombetare per perdorim fundor eshte kunder praktikes se tarifave me te uleta me shumice ne krahasim me tarifate me pakice, dhe perben sjellje antikonkurrese:
    - shitja e linjave me qera nderkombetare kompanive te telekomunikacioneve qe i perdorin linjat per ofrimin e sherbimeve me pakice, eshte shitje me shumice dhe keto tarifa duhet te jene me te uleta se tarifate e perdorueve fundore te linjave me qera.
  - o Tarifate e linjave me qera kombetare 2 Mbit/s jane disa here me te uleta se tarifate e vendeve te rajonit dhe BE (situat e kundert me periudhen para vitit 2005<sup>9</sup> ku keto tarifa ishin disa here me te larta se tarifa mestare e vendeve te BE);
  - o Diferencat ne tarifate e linjave me qera 64 kbit/s me 2 mbit/s jane shume me te ulet se ne vendet e BE : 40-100% krahsuar me 250-460% ne vendet e BE;
  - o Tarifate e linjave me qera te Albtelecom nuk kane pesuar asnje ndryshim qe prej vitit 2005;

---

<sup>9</sup> Tarifate e linjave me qera jane reduktuar ndjeshem nga Albtelecom gjate vitit 2005 : pe qarqet 2 Mbit/s reduktimi ishte afersihit 10 here : 2000 euro/muaj ne 220 Euro/muaj.

- Tarifat e linjave me qera te Albtelcom ndryhojne ne menyre te konsiuderoesh,me

Per sa me siper, AKEP gjykon se:

- Albtelecom nuk ka ndjere presion konkurrues te tille qe te ofroje tarifa te linjave me qera te orientuara ne kosto;

## VI. Perfundime mbi FNT

Ne analizen e faktoreve te marre ne konsiderate per fuqine e ndjeshme ne tregjet perkates, rezulton se:

- Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 50%<sup>10</sup> te linjave me qera, per numrin e linjave me qera dhe per te ardhurat. Keto nivele megjithese kane ardhur ne renie ne vitin 2007, kane pesuar rritje perseri ne vitin 2008
- Albtelecom eshte aktualisht operator me FNT ne tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe eshte propozuar ne dokumentin per konsultim publik, "Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Konsultim Publik", publikuar nga AKEP me 17.09.2009, si operator me FNT ne kete treg.
- Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rendesishem per te shtrire FNT ne tregun me pakice (dhe me shumice te segmenteve terminuese-lokale) te linjave me qera.
- ***Zevendesimi i sistemit te komplikuar te licensimit me licensa te klasave te ndryshme dhe per zona operimi te parcaktuara me sistemin e autorizimit te pergjithshem perben nje eliminim apo reduktim te ndjeshem te pengesave ligjore ne ofrimin e linjave me qera me pakice.***
- Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me operatoret alternative dhe celulare dhe operatore te rinj te mundshem ne treg, per ofrimin e linjave lokale te telefonise fikse dhe ne kete menyre edhe per ofrimin e linjave me qera.
- Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh ne ofrimin e linjave me qera.
- Mbulimi i kufizuar territorial nga operatoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem em Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar linja me qera apo lidhje te dedikuara ne zona te ndryshme gjeografike.
- Mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare: operatoret celulare kane rrjet kombetar backbone mikrovalor qe e shfrytezojne kryesisht per rrjetet GSM, por mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare, perben disavantazh per keta operatore per ofrimin e linjave me qera, pasi do te duhet et ndertojne rast pas rasti keto lidhje lokale (nderkohe qe Albtelecom ne me te shumten e rasteve i ka te gatshme).
- Aftesia e konkurrences se mundshme ne kete treg, ne formen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurrues ete operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me albtelecom ne ofrimin e linjave me qera, eshte i madh.

---

<sup>10</sup> Pjesa e tregut te Albtelecom sipas te dhenave periodike te Albtelecom eshte shume me e madhe, ne nivele mbi 80%. Ketu e ne vijim do ti referohemi pjese se tregut te Albtelecom sipas te dhenave te depozituar per Analizen, e cila megjithese ka ndryshim te madh nga te dhenat periodike nuk ndikon ne perfundimet e AKEP. Sqarimi i kontradites ne te dhena do te kryhet gjate periudhes se konsultimit publik.

- *Megjithë eliminimin apo reduktimin e ndjeshëm të pengesave ligjore, që erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator të autorizimeve të përgjithshme, Albtelecom vazhdon të ketë avantazhe ndaj operatoreve të tjerë për shkak të ekonomive të shkallës, ekonomive të densitetit, integritetit vertikal. Këto avantazhe të Albtelecom, në rrjetin lokal dhe backbone, ndikojnë pozitivisht në aftësinë ndikuese të Albtelecom në tregjet me pakicë të linjave me qera.*
- Ofrimi i linjave me qera është i varur nga vendodhja e ambienteve që do lidhen, dhe avantazhet e Albtelecom të lidhur me prezencën në rrjet në nivel kombëtar, ulin aftësinë negociuese të blerësve, pasi Albtelecom shpesh është i vetmi operator që mund të sigurojë shërbimin e kërkuar nga blerësi.
- Albtelecom nuk ka ndjere presion konkurrues të tilla që të ofrojnë tarifa të linjave me qera të orientuara në kosto;
- Tarifat e linjave me qera të Albtelecom kanë disproporcione të konsiderueshme në strukturën e tyre:
  - o tarifa shumë më të larta për kompanitë e telekomunikacioneve se kompanitë që i blejnë linjat me qera ndërkombëtare për përdorim fundor është kundër praktikës së tarifave më të ulëta me shumicë në krahasim me tarifën me pakicë, dhe përben sjellje antikonkurruese:
    - shitja e linjave me qera ndërkombëtare kompanive të telekomunikacioneve që i përdorin linjat për ofrimin e shërbimeve me pakicë, është shitje me shumicë dhe këto tarifa duhet të jenë më të ulëta se tarifat e përdoruesve fundorë të linjave me qera.
  - o Tarifat e linjave me qera kombëtare 2 Mbit/s janë disa herë më të ulëta se tarifat e vendeve të rajonit dhe BE (situatë e kundërt me periudhën para vitit 2005<sup>11</sup> ku këto tarifa ishin disa herë më të larta se tarifa më të ulëta të vendeve të BE);
  - o Diferencat në tarifën e linjave me qera 64 kbit/s me 2 mbit/s janë shumë më të ulëta se në vendet e BE : 40-100% krahasuar me 250-460% në vendet e BE;
  - o Tarifat e linjave me qera të Albtelecom nuk kanë pesuar asnjë ndryshim që prej vitit 2005;

Duke marrë në konsideratë faktorët (argumentat) e mësipërm, AKEP gjykon se:

**Albtelecom përmbush kriteret për fuqi të ndjeshme në tregun përkatës me pakicë të minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuara të linjave me qera deri në dhe përfshirë 2Mb/sek)**

---

<sup>11</sup> Tarifat e linjave me qera janë reduktuar ndjeshëm nga Albtelecom gjatë vitit 2005 : për qarqet 2 Mbit/s reduktimi ishte afërsisht 10 herë : 2000 euro/muaj në 220 Euro/muaj.

***Pyetje per konsultim publik:***

- 1. A mendoni se linjat me qera te kapaciteve 64 Kbit/s deri ne 2 Mbit/s jane pjese e te njetit treg perkates?***
- 2. A mendoni se linjat me qera te kapaciteve mbi 2 Mbit/s jane pjese e tregjeve perkates te ndryshem nag seti minimum i linjave me qera?***
- 3. Cili eshte opinioni juaj per linjat me qera nderkombetare dhe perfshirjen e tyre ne te njetin treg perkates me linajt kombetare?***
- 4. A mendoni se AKEP ka percaktuar drejte tregun me pakice te linjave me qera, setin minimum?***
- 5. A mendoni se Altelecom ploteson kriteret per FNT ne tregun me pakice te linjave me qera?***

## V. ANALIZE E TREGJEVE ME SHUMICE TE LINJAVE ME QERA: SEGMENTET TERMINUESE DHE TRUNK

### IV.I Perkufizimi i tregjeve perkates me shumice te linjave me qera

Sic u theksua ne seksionin\_\_\_\_, linjat me qera mund te blihen nga bleres fundore por edhe nga operatore te rrjeteve apo ofrues sherbimesh, te cilet i blejne linjat me qera per qellime te ofrimit te linjave me qera me pakice apo per ofrimin e sherbimeve te tjere te komunikimeve elektronike. Ne skemen III.1 dhe III.2, percaktuam grafikisht ndarjen e segmenteve terminues dhe segmenteve trunk te linjave me qera.

- **“Terminime Lokale te Linjave me qera”** jane pjese te linjave me qera qe lidhin centralin lokal me ambientet apo ndertesat e klientit
- ***Trank Segmente ose Trank Seksione*** jane pjese te linjave me qera qe ndodhen mes dy nyjave kryesore te rrjetit te ndertua: lidhja midis centraleve lokale dhe tranzite.
- **Kufiri ndares midis segmenteve terminuese dhe trunk eshte centrali qe lidhet direkt me perdoruesin fundor te linjes me qera;**

### I. Dimensioni i produkteve/sherbimeve te tregjeve me shumice te linjave me qera

Sic u theksua ne seksion\_\_\_\_, nga pergjigjet e pytsoreve per te dhenat e linjave me qera, koncepti i shitjes me shumice te linjave me qera nuk eshte i zhvilluar apo konsoliduar. Te gjithë operatorët deklaruan se nuk shesin linja me qera me shumice, pervec AMC e cila deklaroi se i ka shitur OTE pjese trunk te linjave me qera. Nderkohe Altelecom deklaroi dy cmime te ndryshme te shitjes se linjave me qera nderkombetare, nje per kompanite e telekomunikacioneve dhe nje per kompani jo te telekomunikacioneve. Gjithastu nga te dhenat e Altelecom, nje nder bleresit kryesore te linjave me qera kombetare eshte Eagle Mobile.

Megjithate, sic e theksuam ne analizen e linjave me qera me pakice, ofrimi i linjave me qera nje operatori apo ofruesi sherbimesh, si inpute per aktivitetin e ketij operatori/ofruesi (shitje me pakice, pjese rrjeti etj), perben shitje me shumice te linjave me qera. Ne kete rast, linja me qera ofrohet si edhe nje perdoruesi fundor, por fakti qe bleresi eshte ofrues sherbimesh/rrjete te komunikimeve elektronike, dhe e perdor linjen me qera si input per ofrimin e sherbimeve/rrjeteve te komunikimeve elektronike perdoruesve fundore, e ben kete linje me qera me shumice. Kerkesa per linja me qera me shumice eshte kerkesa e derivuar nga tregjet me pakice te linjave me qera si edhe nga kerkesa per sherbime te tjera te komunikimeve elektronike.

Forma te tjera te shitjes me shumice te linjave me qera, jane shitjet e kapaciteteve transmetuese te dedikuara ne nivele trunk dhe/ose segmente terminuese te linjave me qera. Bleresit e ketyre sherbimeve zoterojne nje pjese te infrastruktures se nevojshme dhe jane te interesuar per pjese te vecanta te kapaciteteve transmetuese, per te plotesuar infrastrukturen e tyre me qellim ofrimin e linjave me qera apo sherbimeve te tjera te komunikimeve elektronike. Shitja e linjave me qera ne kete form te pjesshme te tyre, ne vende te tjera njihet si shitje e qarqeve private te pjesshme (Partial Private Circuits-PPC) apo qarqet e pjesshme te linjave me qera (leased line part circuit-LLPC)

Nje PPC mund te perdoret per te ofruar kapacitet simetrik midis dy pikave, njera prej te cilave eshte pika e dorezimit operatorit tjeter, dhe pika pika tjeter eshte pika fundore e rrjetit (Network Termination Point-NTP). Zakonisht, nje PPC perfshin nje segment terminimi dhe nje segment trunk. PPC jane sherbim me shumice duke i lejuar nje operatori qe ka investuar ne infrastrukture te ofroje linja me qera ne nivel me pakice apo qarqe per perdorim te vet, me qellim ofrimin e sherbimeve te tjera. PPC jane te ngjasme me linjat me qera, pasi ofrojne kapacitet simetrik midis dy pikave. Megjithate, PPC ndryshojne nga linjat me qera, ne menyren e ofrimit te kapacitetit. Nj elinje me qera 2mbit/s ofron kapacitet 2 mbit/s ne dy pikat A dhe B, ku pika A eshte pike fundore en rrjet dhe pika B pike tjeter fundore apo pika e prezences se operatorit tjeter. PPC ofron 2mbits ne piken A, por ne piken B mund te ofrohet su pjese e nje kapacitet te madh ne te cilen mblidhen shume PPC. Zakonisht PPC i lejojne operatoreve te rrisin eficiencen e rrjeteve duke mbledhur te gjitha qarqet (PPC dhe/ose qarqe interkoneksioni) ne nje pike dhe nje linje transporti te vetme: piken e interkoneksionit dhe qarkun e interkoneksionit (qarqet e interkoneksionit dhe te kapaciteve te PPC mun te jene te ndara por jane pjese e nje qarku te vetem transportues).

Rekomandimi i KE, 2005/268/EC<sup>12</sup>, perkufizon qarqet e pjesshme te linjave me qera (leased line part circuit'-LLPC), si linja e dedikuar midis godines se klientit dhe pikes se interkoneksionit te operatorit te rrjetit tjeter (ne ose afer) nyjes se rrjetit te operatorit me FNT. Ky sherbim duhet percaktur si sherbim i vecante me shumice i linjave me qera, qe mund te perdoret nga opertoret e tjere per te ofruar sherbime perdoruesve me pakice, operatoreve te tjere ose per perdorim te tij, si, por jo i kufizua vetem ne, linja me qera, lidhje me rrjetin e komutuar telefonik, sherbime te dhenash apo akses broadband. Ky rekomandim, gjithashtu citon se ofrimi i qarqeve te pjesshme te linjave me qera eshte pjese e tregut me shumic te segmenteve terminuese te linjave me qera , dhe per gjatesi te mjaftueshme eshte pjese edhe e tregut me shumice te segmenteve trunk te linjave me qera.

Ky produkt/sherbim nuk rezulton te ofrohet ne Shqiperi. Megjithate, bazuar ne marrveshjet e interkoneksionit, Albtelecom ve ne dispozicion te operatoreve te tjere, kapacitete transmetuese ne formen e linjave E1 2 Mbit/s me qellim lidhjen e pikes se interkoneksionit te Albtelecom me piken e prezences se operatorit tjeter, kur operatori tjeter nuk mund te siguroje vete apo nga te tjere, kete lidhje. Keto kapacitete perdoren per Interkoneksionin e ndermjetem dhe tarifohen nga Albtelecom ne baze te nje formule perdorimi te tyre (trafikun i shkembyer) dhe me reference cmimin e linjave me qera 2 Mbit/s, apo te fibres optike dhe linjave te bakrit. AKEP gjykon se keto kapacitete te rrjetit backbone te Albtelecom te ofruara operatoreve te tjere per interkonektim te ndremjetem me Albtelecom, megjithese jane per perdorim te perbashket (Albtelecom dhe Operatori tjeter shkembjeme trafik ne ket linja), perbejne pjese te tregjeve te linjave me qera me shumice, segmentet trunk te tyre.

Per sa me siper, AKEP gjykon se ***linjat me qera me shumice dhe PPC apo LLPC jane pjese e te njejtit treg perkates, dhe pjese e tregjeve me shumice te segmenteve terminuese dhe segmenteve trunk te linjave me qera.*** Ndryshimi midis linjave me qera me shumice dhe PPC apo LLPC eshte se linjat me qera me shumice perfshijne dy segmente terminuese, ndersa PPC perfshijne vetem nje, pasi nje pike eshte ne piken e interkoneksionit me operatorin ofrues, dhe jo pike fundore ne rrjetin e tij.

---

<sup>12</sup> COMMISSION RECOMMENDATION of 29 March 2005 “on the provision of leased lines in the European Union — Part 2 — pricing aspects of wholesale leased lines part circuits” (2005/268/EC)

Segmentet terminuese dhe *segmentet trunk te linjave me qera*, sipas ndarjes se cituar me siper dhe ne skemat III.1 dhe III.2, *jane pjese e tregjeve perkates te ndryshem*, pasi te dy keto segmente nuk mund te konsiderohen zevendesues por plotesues te njeri tjetrit. Ofrimi i segmenteve trunk dhe ofrimi i segmenteve terminuese kane karakteristika te ndryshme, dhe nje operator qe ofron segmente trunk (ne rrjetin backbone te tij), e kate veshtire te ofroje edhe segmente terminuese ne pergjigje te rritjes se cmimit me 5-10% te segmenteve terminuese, pasi ofrimi i segmenteve terminuese do et kerkonte investime te nje natyre tjetere, qe jane te lidhur me rrjetin lokal te nje operatori. Ne te njeten menyre mund te arsyetojme per zvendesimin ne krahun tjetere: ofrimi nga nje operator rrjeti lokal i rrjetit backbone qe te mbuloje me shume zona se zona lokale ku ka investuar. Aktualisht ne Shqiperi, ka shume operatore rrjetesh lokale, por mundesite e tyre te ofrimit te segmenteve trunk ne zona qe nuk mbulohen nga rrjeti i tyre lokal eshte shume i veshtire. Gjithashtu nje sere operatoresh (psh operatoret celulare) kane investuar ne rrjete backbone kombetare, por kane mundesi te kufizuara ofrimi te segmenteve terminuese pasi nuk kane prezence me rrjet lokal qe te mundesoje ofrimin e ketij sherbimi.

Kerkesa per linja me qera me shumice eshte kerkese e derivuar nga tregjet me pakice te linjave me qera si edhe nga kerkesa per sherbime te tjera te komunikimeve elektronike, dhe eshte kerkese e operatoreve per linja me qera. Ndersa kerkesat e perdoruesve fundore mund te jene te tilla qe justifikojne nje ndarje sipas kapacitetit te linjave me qera, ku me te rendesishem gjykohet te jene linjat me qera me kapacitet te ulet (deri ne dhe perfshire 2 Mbit/s), kerkesat e operatoreve per linjat me qera per perdorim te vetin, per ofrimin e sherbimeve te komunikimeve elektronike me pakice, nuk justifikojne nje ndarje apo segmentim sipas kapaciteteve te linjave me qera. Nga ana e ofruesve rrjetet backbone, ndertohen per te perballuar kapacitete te transmetimit te nevojshme per te mbuluar kerkesen ne afat mesme dhe aftagjate, duke agreguar te gjitha kapacitetet e linjave te vecanta me qera. Gjithashtu, rekomandimi i KE, per tregjet perkatese, nuk ben dallim ne kapacitete e linjave me qera me shumice, sic eshte bere pecaktimi per kapacitet e linjave te tregut perkates me pakice te setit minimum te linjave me qera.

AKEP, gjykon se *tregjet perkatese me shumice te linjave me qera, segmenteve terminuese dhe trunk, perfshijne te gjitha kapacitetet e linjave me qera.*

## **II. Dimensioni gjeografik i tregut**

Ne lidhje me dimensionin gjeografik te tregut perkates, Udhezimimi i KE, paragrafet 56, 59 dhe 60 citojne midis te tjerave se dimensionin gjeografik i tregut perkates perfshin zonen gjeografike ne te cilen operojne sipermarresit ofrues dhe kerkues te sherbimeve, zone e cila ka kushte te ngjashme te konkurrences, si dhe praktiken tradicionale te percaktimit te tregjeve te sherbimeve te komunikimeve elektronike ne baze te zonave te mbuluara nga rrjeti.

Albtelecom dhe operatoret e rrjeteve celulare ne baze te licensave individuale te Klases 1, te zevendesuar me autorizime individuale dhe te pergjithshme, ofrojne sherbimet e tyre ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Nderkohe operatoret alternative te rrjeteve fikse, ne baze te sistemit te autorizimeve et pergjithshme, megjithese kane mbulim te kufizuar territorial ne disa zona, nuk kane kufizime ne zonen e mbulimit me rrjet. Ne kete menyre mund te konkludojme se:

*Dimensioni gjeografik i sherbimeve me shumice, segmenteve terminuese dhe segmente trunk te linjave me qera eshte kombetar, d.m.th territori i Republikes se Shqiperise.*



## IV.2 Analiza per FNT: tregjet me shumice te linjave me qera

Per te analizuar ekzistencen apo jo te fuqise se ndjeshme ne treg, neni 33 percakton nje sere kriteresh qe duhet te merren ne konsiderate, dhe midis te tjerave citon:

2. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP-i bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:

a) në madhësinë e sipërmarrësit, madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij, ndaj lojtarëve të tregut;

b) në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;

c) në fuqinë kundërvepruese të blerësve;

ç) në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;

d) në fazën e tregut përkatës;

dh) në përparësitë teknologjike;

e) në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;

ë) në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;

f) në shkallën e integritit vertikal;

g) në zhvillimin e produkteve të diferencuara;

gj) në aksesin në burimet financiare;

h) në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;

i) në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifatat, paketat e shërbimeve dhe të produkteve ose vendosjen e pengesave.

Lista e kriterëve nuk është listë kumulative apo përjashtuese e kriterëve/karakteristikave të tjera për dominancë apo FNT.

### I. Pjesët e tregut

Sic është theksuar në seksionin e analizës për FNT në tregun me pakice të linjave me qera, AKEP, nga pyetsoret e derguar operatorëve për këto analizë tregu, koncepti i shitjes me shumice të linjave me qera nuk është i zhvilluar apo konsoliduar. Të gjithë operatorët deklaruan se nuk shesin linja me qera me shumice, përveç AMC e cila deklaroi se i ka shitur OTE pjesë të linjave me qera. Nderkohe Albtelecom deklaroi dy çmime të ndryshme të shitjes së linjave me qera ndërkombetare, një për kompanitë e telekomunikacioneve dhe një për kompani jo të telekomunikacioneve. Gjithashtu nga të dhënat e Albtelecom, një ndër blerësit kryesorë të linjave me qera kombëtare është Eagle Mobile.

Bazuar në këto të dhëna, në tabelat e mëposhtme janë paraqitur numri i linjave me qera me shumice të Albtelecom dhe AMC, dhe pjesët e tregut të Albtelecom për numrin të ardhurta nga linjat me qera me shumice.

Tabela V.1 Numri i Linjave me qera me shumice të Albtelecom dhe AMC

	2006	2007	2008
<b>Kombetare (EM)</b>	0	0	154

<b>Nderkombetare me shumice</b>	20	20	20
Albtelecom	20	20	174
<b>AMC</b>	7	9	9
<b>Total</b>	27	29	183

Tabela V.2 Pjeset e tregut te linjave me qera me shumice te Albtelecom

	2006	2007	2008
Numri i Linjave	74%	69%	95%
Te ardhura	41%	36%	76%

Sipas te dhenave te mesiperme, Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 50% te linjave me qera, per numrin e linjave me qera dhe per te ardhurat. Pjesa e tregut per te ardhura, per vitet 2007 dhe 2008 eshte me e vogel se 50% dhe me e vogel se pjesa e AMC.

Megjithate, AKEP gjykon se pjeset e tregut te Albtelecom per numrin e linjave dhe te ardhura mund te jene me te medha, nese do te perfshinim kapacitetet e dhena nga Albtelecom per operatoret per interkoneksion.

Megjithate, bazuar ne marrveshjet e interkoneksionit, Albtelecom ve ne dispozicion te operatoreve te tjere, kapacitete transmetuese ne formen e linjave E1 2 Mbit/s, Fiber optike apo linja bakri, me qellim lidhjen e pikes se interkoneksionit te Albtelecom me piken e prezences se operatorit tjetër, kur operatori tjetër nuk mund te siguroje vete apo nga te tjere, kete lidhje. Ne baze te informacionit te derguar nga Albtelecom, me shkrese 6958, date 29.09.2009, per interkoneksionin e ndermjetem, rezulton se 28 operatore kane marre ne perdorim mjete transmetimi nga Albtelecom si me poshte:

- 8 Fiber Optike (4-13 km)
- 18 E1
- 16 kopje bakri

Vlera e detyrimeve te ketyre operatoreve, apo te ardhurat e Albtelecom per muajin Gusht 2009, eshte vleresuar te jete 422 mije leke.

Perfshirja e tyre ne te dhanet e perdorura, do te rriste pjese e tregut te Albtelecom: me shume per numrin e qarqeve se per te ardhura.

Pjesa e tregut ne te ardhur ae Albtelecom eshte me vogel se pjesa e tregut ne numer qarqesh, pasi qaqret e Albtelecom jane me kapacitete me te uleta (kryesisht 2 Mbit/s) se ato te AMC, te cila jane 34 Mbit/s, duke rezultuar ne te ardhura me te vogla per qark.

Linjat me qera te dhena Eagle Mobile mund et konsiderohen se permbajne dy segmente terminuese dhe nje segment trunk. Qarqet e dhena per inerkoneksion mund te konsiderohen segmente trunk si edhe qarqet e dhena nga AMC.

Pjeset e tregut me shumice, nuk jane detajuar ne segmente terminuese dhe segmente trunk, per shkak te mos detajimit nga operatoret. Megjithate, AKEP gjykon se detajimi ne segmente terminuese dhe segmente trunk, nuk do te sillte ndryshime te ndjeshme.

Pjeset e tregut te Albtelecom ne nivele mbi 50% te linjave me qera, per numrin e linjave me qera dhe per te ardhurat, jane shenje e fuqise se ndjeshme te Albtelecom ne tregjet eme shumice te linjave me qera. Ne Udhezimin e BE, shprehet qarte se pjesa e tregut me e madhe se 50 per qind eshte nje tregues i padiskutueshem i fuqise se ndjeshme ne treg dhe, vetem ne raste te rralla mund te ndodhe qe nje operator me pjese tregu te tille te mos kete fuqi te ndjeshme ne treg<sup>13</sup>.

Gjithashtu nje percaktim i rendesishem i nenit 33 per FNT, te Ligjit 9918, eshte pika 5:

*5. Kur një sipërmarrës ka fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, ai vlerësohet se mund të ketë fuqi të ndjeshme në treg edhe në një treg përkatës tjetër, të lidhur horizontalisht, vertikalisht ose gjeografikisht me tregun e analizuar, nëse lidhjet ndërmjet dy tregjeve janë të tilla që mundësojnë shtrirjen e fuqisë së ndjeshme nga tregu i parë në tjetrin, duke fuqizuar kështu fuqinë e sipërmarrësit në treg.*

Albtelecom eshte aktualisht operator me FNT ne tregun me pakice te aksesit ne rrjet telefonik publik nga vendodhje fikse, dhe eshte propozuar ne dokumentin per konsultim publik, "Analize e Tregut te Telefonise Fikse: Tregjet me pakice te aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumice te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit ne rrjete fikse: Konsultim Publik", publikuar nga AKEP me 17.09.2009, si operator me FNT ne kete treg. Sipas te dhenave te Tabeles III.1 (dokumenti i Analizes se cituar), Albtelecom zoteron pjese tregu ne nivele mbi 80% te pajtimtareve (aksesit), dhe mbi 90% per te ardhurat. Prezenca kombetare e Albtelecom me rrjet lokal (linja fundore) dhe statusi me FNT ne kete treg, eshte faktor qe konsiderohet i rendesishem per te shtrire FNT ne tregjet me shumice te segmenteve terminuese-lokale te linjave me qera.

## **II. Pengesat per hyrje dhe Konkurrenca e mundshme ne tregun e linjave me qera**

Analiza ne kete seksion eshte e ngjashme me analizen e tregut me pakice te linjave me qera, pasi pengesat qe ekzistojne ne tregun me pakice dhe avantazhet e Albtelecom ne tregun me pakice, derivojne pikersisht nga pengesat per hyrje ne treg me rrjet beckboen dhe lokal, te dodmosdodhem per ofrimin me shumice te kapaciteteve te rrjetit.

Pjesa e madhe e tregut e nje operatori mund te mos jete tregues i fuqise se ndjeshme ne treg, ne rast se nuk plotesohen nje sere kushtesh te tjera. Nje nder keto kushte eshte edhe ekzistenca e barrierave ne treg. Nese nje operator ka pjese te madhe ne treg, por nderkohe tregu eshte i hapur ndaj operateve te rinj, te cilet mund te hyjne dhe dalin nga tregu pa kufizime ligjore dhe kosto ekonomike, atehere aftesia e nje operatori me pjese te madhe tregu per te ndikuar ne kete treg eshte e kufizuar.

### **Pengesa ligjore**

---

<sup>13</sup> According to established case-law, very large market shares — in excess of 50 % — are in themselves, save in exceptional circumstances, evidence of the existence of a dominant position (78). An undertaking with a large market share may be presumed to have SMP, that is, to be in a dominant position, if its market share has remained stable over time.

Sic eshte theksuar edhe ne seksione te tjera, per ofrimin e linjave me qera nuk ka pasur pengesa ligjore per operatoret alternative dhe operatoret celulare, pervec kufizimit te zones se aktivitetit te operatoreve alternative (me pare rurale) vetem ne zona rurale dhe me vone ne disa rajone. Ndryshimi kryesor ne lidhje me pengesat per hyrjen ne treg, eshte liberalizmi i tregut dhe lehtesimi i procedurave per sipermarresit ne sektorin e komunikimeve elektronike, qe solli hyrja ne fuqi me 26.06.2008 e Ligjit nr.9918, date 19.05.2008 "Per komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise" dhe kuadrit rregullator te tij, vecanerisht sistemi i autorizimeve te pergjithsme. Hyrja ne fuqi e ketij Ligji ka hequr pengesat ligjore per ofrimin e sherbimeve dhe rrjeteve te komunikimeve elektronike ne shkalle kombetare qe ekzistonin ne Ligjin e meparshem 8618. Per sektorin e telefonise fikse dhe ofrimin e linjave me qera nuk ekzistojne me pengesa ligjore per ofrimin e sherbimeve dhe rrjeteve fikse ne shkalle kombetare perfshire zonat urbane.

***Zevendesimi i sistemit te komplikuar te licensimit me licensa te klasave te ndryshme dhe per zona operimi te parcaaktuara me sistemin e autorizimit te pergjithshem perben nje eliminim apo reduktim te ndjeshem te pengesave ligjore ne ofrimin e linjave me qera me pakice.***

Megjithte keto ndryshime ligjore, ne ofrimin e linjave me qera me shumice (dhe me pakice) ekzistojne pengesa strukturore. AKEP gjykon se konkurrenca e mundshme nga operatoret aktuale dhe te rinj per nje periudhe afatmesme nuk do te jete e mjaftueshme per te kufizuar apo eliminuar aftesine ndikuese ne treg te Albtelecom, per arsye se Albtelecom zoteron disa avantazhe ndaj operatoreve aktuale dhe te mundshem te cilat do te vazhdoje t'i kete edhe ne nje periudhe afatmesme. Nder keto avantazhe te Albtelecom, apo pengesa strukturore te tregut linjave me qera, mund te permendim avantazhet qe vijne si operator rrjeti kombetar te telefonise fikse (rrjet lokal dhe backbone)<sup>14</sup>:

#### **Ekonomite e shkalles**

Ekonomite e shkalles perfitohen kur kostoja per njesi e sherbimit zvogelohet me rritjen e sasise se sherbimit. Ne ofrimin e sherbimeve te telekomunikacioneve, ekonomite e shkalles jane te konsiderueshme, dhe kjo perben nje pengese per operatoret te rinj per te konkurruar me nje operator me rrjet te shtrire ne te gjithë territorin e nje vendi. Operatori Albtelecom si operatori i rrjetit me te madh te telefonise fikse (rrjeti lokal dhe backbone), zoteron nje avantazh te konsiderueshem per ekonomite e shkalles, ne raport me operatoret alternative dhe celulare dhe operatoret te rinj te mundshem ne treg, per ofrimin e linjave lokale te telefonise fikse dhe ne kete menyre edhe per ofrimin e linjave me qera.

Albtelekom duke patur nje rrjet infrastrukturor backbone edhe ne tregun e linjave me qera trashegon nje status te tille (perfshire edhe setin minimum te linjave me qera me kapacitet deri ne 2 Mbit/s). Dimensioni i shtrirjes se rrjetit perben nje pozicion dominant ne raport me sipermarres te tjere ne kete treg. Vodafone Albania dhe AMC qe sipas te dhenave te servitura per kete analize kane te ngritur nje infrastrukture duke shfrytezuar kapacitetet e lira te rrjetit te transmetimit, serish teknologjia e transmetimit eshte e mbeshetur sistemin e lidhjeve radio-rele dhe vetem per distanca te vogla me lidhje kabllore kryesisht kur perdoruesi fundor eshte gjeografikisht afer dhe mundesohet aksesimi per te. Ne ndryshim nga kjo, Albtelekom ka prezence me nje infrastrukture me kapacitet ne shtrirje gjeografike si dhe me kualitet me te larte dhe

---

<sup>14</sup> Avantazhe te permendura edhe ne Analize 2007 dhe 2009 te telefonise fikse.

ne ofrimin e ketij sherbimi dhe si rrjedhoje kjo perben nje avantazh te Albtelekom ne raport me ofruesit e tjere te linjave me qera ne tregun e pakices pjese e te cilit eshte edhe seti minimum i linjave me qera.

### **Ekonomite e densitetit**

Albtelecom, zoteron gjithashtu avantazhin e ekonomive te densitetit (dendesise) per rrjetin e aksesit d.m.th kosto me te uleta per zona me dendesi me te madhe, te cilat i krijojne avantazh ne ofrimin e linjave me qera. Albtelecom ka qene i vetmi operator rrjeti i lejuar te ndertoje rrjet ne zonat urbane te cilat jane zona me dendesi shume me te madhe se zonat rurale. Me liberalizimin e tregut ne zonat urbane kete avantazh do ta kene edhe operatoret qe investojne ne keto zona ne krahasim me operatoret ne zonat rurale.

### **Lojtari i pare ne Treg**

Albtelecom zoteron gjithashtu avantazhin e lojtarit te pare ne treg (first mover advantage). Albtelecom, megjithese me nje numer te vogel te perdoruesve, eshte prezent me infrastrukture ne te gjitha zonat urbane, dhe ne krahasim me nje operator te ri ka avantazh. Kjo prezence i jep mundesine qe te kete kosto me te uleta per te zgjeruar rrjetin ne keto zona dhe ofrimin e linjave me qera, ne krahasim me operatore te rinj qe duhet te fillojne investimet nisur nga niveli zero i perdoruesve dhe infrastrukture nga fillimi.

### **Integrimi vertikal**

Prezenca e nje operatori ne dy nivele te tregjeve, me shumice dhe me pakice, d.m.th. integrimi vertikal rrit aftesine ndikuese ne treg te operatorit. Operatoret e rrjeteve telefonike publike jane vertikalisht te integruar. Avantazhet e krijuara nga madhesia e rrjetit (niveli me shumice), prezenca me linja abonentesh ne te gjitha rrethet e RSH (niveli me pakice) te operatorit Albtelecom jane shume me te medha se ato te operatoreve te tjere (rurale) dhe operatoreve te rinj te mundshem ne treg. Nje operator vertikalisht i integruar, ka mundesine qe te krijojte avantazhe (diskriminoje) per pjesen e tij te ofrimit te sherbimeve ne nivelin me pakice ndaj konkurrenteve te tjere per keto tregje perkatese me pakice, duke perdorur aftesine ndikuese ne nivelin (tregjet) me shumice, pra duke ofruar sherbimet (inpute per tregjet me pakice) ne nivelin me shumice konkurrenteve te tij me cmime me te larta se ai ofron per pjesen e vet retail (kjo ceshtje trajtohet me gjere ne pjesen e tregjeve me shumice).

Avantazhet e mesiperme te Albtelecom, perforcohen edhe nga kufizimet e operatoreve alternative dhe operatoreve celulare per te konkurruar albtelecom ne ofrimin e linjave me qera:

- Mbulimi i kufizuar territorial nga operatoret alternative: prezenca me infrastrukture e operatoreve alternative ne zona te vecanta (asnje operator alternativ nuk ka mbulim kombetar me rrjet te krahasueshem em Albtelecom), dhe mungesa e infrastruktures alternative ne zona te vecanta ul aftesite e tyre konkurruese per te ofruar linja me qera apo lidhje te dedikuara ne zona te ndryshme gjeografike.
- Mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare: operatoret celulare kane rrjet kombetar backbone mikrovalor qe e shfrytezojne kryesisht per rrjetet GSM, por mungesa e rrjetit lokal per operatoret celulare, perben disavantazh per keta operatore per ofrimin e linjave me qera, pasi do te duhet et ndertojne rast pas rasti keto lidhje lokale (nderkohe qe Albtelecom ne me te shumten e rasteve i ka te gatshme).

Aftesia e konkurrences se mundshme ne kete treg, ne fiormen e hyrjeve te reja ne treg apo rritjes se mundesive konkurrues ete operatoreve alternative, per nje periudhe afatmesme eshte e kufizuar, per shkak te faktoreve te permendur me siper. Investimi ne infrastrukture alternative i nevojshem per te konkurruar me albtelecom ne ofrimin e linjave me qera, eshte i madh.

Aktulisht, USAID eshte ne proces te nje studimi feasibilitetit, per ndertimin e nje rrjeti backbone me fiber optike, i cili do te mbuloje te gjithe Shqiperine. Ndertimi dhe funksionimi i ketij rrjeti backbone, pritet te kete nje efekt pozitiv edhe ne konkurrencen per dhenien e linjave me qera. Megjithate, ky projekt eshte ende ne faze studimi dhe implementimi i plote tij, nuk gjykohet se do te perfundoje brenda nje afati dy vjecar te kesaj analize tregu.

***Megjithe eliminimin apo reduktimin e ndjeshem te pengesave ligjore, qe erdhi si pasoje e Ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator te autorizimeve te pergjithshme, Albtelecom vazhdon te kete avantazhe ndaj operatoreve te tjere per shkak te ekonomive te shkalles, ekonomive te densitetit, integritit vertikal. Keto avantazhe te Albtelecom, ne rrjetin lokal dhe backbone, ndikojne pozitivisht ne aftesine ndikuese te Albtelecom ne tregjet me shumice te linjave me qera.***

### **III. Fuqia kundervepruese e bleresve te linjave me qera**

Pozita e nje operatori, qe eshte dominant ne ofrimin e nje sherbimi, mund te jete me e dobet nese ekzistojne bleres te sherbimit, te cilet zoterojne fuqi te larte negociuese. Fuqia e larte negociuese eshte rezultat, kryesisht, i sasise se madhe te sherbimit te kerkuar nga pala blerese, dhe interesit te shitesit per te mos humbur kete klient. Bleresit me pakice te linjave me qera jane kompani apo institucione te cilat kane nevojte te lidhin ambiente te ndryshme nepermjet kapaciteteve te dedikuara. Ofrimi i linjave me qera eshte i varur nga vendodhja e ambienteve qe do lidhen, dhe avantazhet e Albtelecom te lidhur me prezencen me rrjet ne nivel kombetar, ulin aftesine negociuese te bleresve, pasi Albtelecom shpesh eshte i vetmi operator qe mund te siguroje sherbimin e kerkuar nga bleresi.

### **IV. Tarifimi i linjave me qera me shumice**

Sic u theksua ne seksionin e analizes se tarifave te linjave me qera me pakice, Albtelecom nuk ben dallim midis shitjes me shumice dhe me pakice te linjave me qera, duke aplikuar te njejtat tarifa per qarqet kombetare, dhe tarifa me te larta per qarqet nderkombetare te dhena operatoreve te telekomunikacioneve (pra shitje me shumice) se perdoruesve fundore te tyre (kompani jo telekomunikacioni).

- tarifa shume me te larta per kompanite e telekomunikacioneve se kompanite qe i blejne linjat me qera nderkombetare per perdorim fundor eshte kunder praktikes se tarifave me te uleta me shumice ne krahasim me tarifate me pakice, dhe perben sjellje antikonkurruese:
  - o shitja e linjave me qera nderkombetare kompanive te telekomunikacioneve qe i perdorin linjat per ofrimin e sherbimeve me pakice, eshte shitje me shumice

- Tarifat e linjave me qera kombetare me shumice 2 Mbit/s jane disa here me te uleta se tarifat me pakice te vendeve te rajonit dhe BE (situat e kundert me periudhen para vitit 2005<sup>15</sup> ku keto tarifa ishin disa here me te larta se tarifa mestare e vendeve te BE);
  - o Diferencat ne tarifat e linjave me qera 64 kbit/s me 2 mbit/s jane shume me te ulet se ne vendet e BE : 40-100% krahasuar me 250-460% ne vendet e BE;
  - o Tarifat e linjave me qera te Albtelecom nuk kane pesuar asnje ndryshim qe prej vitit 2005;
- Tarifat e Albtelecom per qarqet nderkombetare me shumice (operatoreve te telekomunikacionve) 64 kbit/s:
  - o Jane me te larta se tarifat me pakice ne rajonin SEE dhe 85% me te larta se mesatarja e BE;
- Tarifat e Albtelecom per qarqet nderkombetare me shumice (operatoreve te telekomunikacionve) 2 Mbit/s:
  - o Jane me te larta se tarifat me pakice ne rajonin SEE dhe 76% me te larta se mesatarja e BE;

Krahasimi i mesiperm eshte bere ndermjet tarifave te linjave me qera me shumice te Albtelecom me tarifat e linjave me qera me pakice ne vendet e tjera. Informacioni per tarifat e linjave me qera me shumice ne vende te tjera eshte i kufizuar ne tarifat e qarqeve te pjesshme te linjave me qera. Tarifat per keto qarqe jane publikuar ne vitin 2007, ne Raportin e 12 te Implementimit te BE (*European Electronic communications regulation and markets 2006 (12th report)*), raport i cili ka dhene dhe tarifat mestare te ketyre qareve ne vendet e BE, per distanca 2 dhe 5km. Nderkohe, dokumenti COMMISSION RECOMMENDATION of 29 March 2005 “*on the provision of leased lines in the European Union — Part 2 — pricing aspects of wholesale leased lines part circuits*” (2005/268/EC), rekomandon rregullatoret qe te sigurojne aplikimin e cmimeve tavan per qarqet e pjesshme te linjave me qera me shumice, te dhena ne Aneks 1 te rekomandimit. Produkti qe do te ishte i krahsueshem me qarqet e pjesshme me qera, do te ishte qarqet e dhena nga Albtelecom operatoreve et tjere, per interkoneksionin e ndermjetem. Ne tabelen e meposhteme eshte bere krahsimi i tarifave te Albtelecom per qarqet 2 Mbit/s te dhena per perdorim per operatoret e tjere per interkoneksion te ndermjetem, me tarifat mestare te vendeve te BE (Raporti i 12 i Implementimit) dhe tarifat e rekomanduara nga BE me 2005/268/EC.

**Tabela V.3 Krahasimi i tarifave te linjave me qera me shumice te Albtelecom dhe BE**

Distanca	Kapaciteti	Albtelecom	2005/268/EC	Mesatare BE 2006
2 km	2 Mbit/s	203	186	334
5 km	2 Mbit/s	203	248	367
15 km	2 Mbit/s	436	333	
50 km	2 Mbit/s	436	539	

<sup>15</sup> Tarifat e linjave me qera jane reduktuar ndjeshem nga Albtelecom gjate vitit 2005 : pe qarqet 2 Mbit/s reduktimi ishte afersiht 10 here : 2000 euro/muaj ne 220 Euro/muaj.

Nga ky krahasim mund te vihet re se:

- per distanca deri ne 2 km, tarifa e Albtelecom eshte me larte se tarifa e rekomanduar, por shume me ulet tarifa mesatare e vendeve te BE.
- Per qarqet deri ne 5km, tarifa e Albtelecom eshte me e ulet se tarifa e rekomanduar dhe shume me ulet se tarifa mesatare e vendeve et BE;
- Per qarqet deri ne 15km, tarifa e Albtelecom eshte me e larte se tarifa e rekomanduar dhe per qarqe deri ne 50 km, tarifa e Albtelecom eshte me ulete se tarifa e rekomanduar

Nderkohe, per linjat (e plota) me qera me shumice, te njejta me ato me pakice, me ndryshimin se bleresi eshte operator dhe jo perdorues fundor i tyre, ne Irlande aplikohet nje tarife 20% me e ulete se tarifa respektive me pakice.

## V Perfundim per FNT

Nga sa a analizua me siper ne kete seksion, AKEP gjykon se sipermarresi Albtelecom sh.a permbush kriteret per FNT ne:

- o **tregun me shumice te segmentev terminuese te linjave me qera;**
- o **tregun me shumice te segmentev trunk te linjave me qera**

### *Pyetje:*

6. *A mendosi se eshte e nevojshme te percaktohen dy tregje me shumice te linjave me qera: segmente terminuese dhe segmente trunk te tyre?*
7. *Cili eshte opinioni juaj per tregjet perkates me shumic ete linjave me qera te perkufizuar nga AKEP?*
8. *Cfare opinioni keni per nivelin e tarifave te linjave me qerame shumice te Albtelecom?*
9. *Cfare ndikimi kane operatoret e tjere(pervec Albtelecom) ne ofrimin e linjave me qera me shumice dhe me pakice: ne terma te cmimeve, kapaciteteve dhe cilesise se ofruar?*
10. *A mendoni se Albtelecom permbush kriteret per FNT ne tregjet me shumice te linjave me qera?*

## **VI. MASAT RREGULLUESE PER FNT NE TREGJET ME SHUMICE DHE ME PAKICE TE LINJAVE QERA**

Ne baze te analizes se kryer rezulton se Albtelecom permbush kushte per t'u shpallur sipermarrës me FNT ne tregjet perkatese ne vijim:

- **ne tregun perkates me pakice te minimumit te linjave me qera (i cili perfshin lloje te specifikuara të linjave me qera deri ne dhe perfshire 2Mb/sek);**
- **tregun me shumice te segmentev terminuese te linjave me qera;**
- **tregun me shumice te segmentev trunk te linjave me qera.**

Ne baze te parashikimeve te ligjit, neni 34, *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Ne vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatorev me FNT duhet te jene proporcionale me masen e problemit dhe te mos jene barre e tepert per operatorin.

Linjat me qera jane nje input i rendesishem per bizneset e mesme dhe te medha, si dhe per institucione te medha, per komunikim te brendshem te te dhenave apo thirrjeve telefonike. Gjithashtu linjat me qera jane nje input i rendesishem edhe per operatoret e rrjeteve apo te sherbimeve te komunikimeve elektronike, pasi i lejojne operatoret bleres te linjave (kapcitateve transmetuese) te ofrojne rrjete dhe sherbime te komunikimeve elektronike produreve fundore, duke kontribuar ne konkurrence me efektive ne tregjet me pakice te sherbimeve te komunikimeve elektronike. Ne kete menyre, ofrimi i linjave me qera ne kushtet e konkurrences efektive, apo i rregulluar ne menyre efektive, do krijoje kushtet per nje mundesi zgjedhjeje, si dhe cmime dhe cilesi te favorshme per bizneset dhe institucionet e mesme dhe te medha si dhe per sipermarrësit e rrjeteve/sherbimeve te komunikimeve elektronike, duke bere nje kontribut te rendesishem ne ekonomine Shqiptare ne teresi.

### **VI.1 Problemet ne konkurrence**

Ne seksionet e analizes per FNT, AKEP ka evindetuar problemet qe ekzistojne me tarifimin e linjave me qera te Albtelecom: niveli dhe struktura e tyre:

- tarifate e linjave me qera jane shume me te uleta ose shume me te larta se niveli mestar ne vendet e rajonit apo te BE;
- tarifate e linjave me qera per operatoret e telekomunikacioneve qe normalisht duhet te trajtohen si tarifa te sherbimi me shumice d.m.th me te uleta se tarifate me pakice, jane aktualisht te njejta per qaret kombetare, dhe me te medha se tarifate me pakice te qareve nderkombetare;

Grupi i Rregullatoreve Europiane (ERG) ne dokumentin , ERG (06) 33, Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework, Final Version May 2006, citon se per shkak te mundesisve dhe stimujve te krijura nga transmetimi i FNT vertikalisht apo horizontalisht, si dhe nga dominanca individuale e

nje operatori ne treg, shpesh ekzsitojne dhe lindin probleme per konkurrencen, te lidhura me cmimin ose me jo, si:

- refuzimi per te dhene akses ne rrjet;
- vonesat per dhenien e aksesit;
- mosdhenie e informacionit;
- aplikimi i kushteve diskriminuese midis operatoreve te ndryshem;
- tarifa shume te larta;
- diskriminim ne tarifa dhe cilesi;
- subvencionim i terthorte;
- investim i tepert apo i manget;
- dhenia e sherbimeve me shporta (bashkimi i sherbimeve) etj

Transmetimi i FNT(**Leveraging of market power**), eshte cdo sjellje nepermjet te ciles nje operator qe ka FNT ne nje treg, transmeton (transferon) fuqine e ndjeshme ne kete treg ne nje treg tjetër i cili eshte potencialisht konkurrues. Transmetimi i FNT mund te jete vertikal ose horizontal, ne varesi te niveleve te te dy tregjeve: nese dy tregjet jane ne te njejtin nivel, transmetimi i FNT eshte horizontal, nese nje prej tregjeve eshte ne nivel me pakice dhe tjetri ne nivel me shumice transmetimi eshte vertikal. Transmetim i fuqise se ndjeshme eshte nje perpjekje (sjellje startegjike) e operatorit OFNT per te nxjerre jashte tregut potencialisht konkurrues rivalet e tij.

Albtelecom eshte propozuar si operator me fuqi te ndjeshme ne tregjet me pakice dhe me shumice te linjave me qera, dhe nje nder arsyet e FNT eshte permendur integrimi vertikal i albtelecom dhe presenca ne te dy nivelet e tregjeve. Albtelecom per shka te FNT ne tregun m shumice te linjaveme qera ka mundesine ta transmetoje kete FNT edhe ne tregun me pakice te tyre, si dhe tregjete me shumice te segmenteve terminuese dhe trunk jane tregjet te lidhur horizontalisht, pasi ofrimi i nje linje me qera, zakonisht ka te nevojshme te dy keto inpute me shumice.

Nder probleme te tjera te cilat jane prezente apo qe mund te lindin ne ofrimin e linjave me qera nga Albtelecom, mund te permendim:

- mungesa e ofrimit te linjave me qera me kapacite te larta 34mbit/s, 155mbit/s
  - Shqiperia eshte i vetmi vend ne rajon qe nuk ka ofrim te linjave 34 mbit/s nga operatori fiks inkumbent.
  - Per keto qarqe, jane te interesuar operoret rrjeteve/sherbimeve te komunikimeve elektronike dhe megjithese kerkesat dhe interesin e tyre per keto qarqe, Albtelecom nuk ka bere te mundur ofrimin e tyre, as ne kushtet e mungeses se rregullimit/kontrollit et tarifave. Kerkesa per keto qarqe, eshte me e madhe per lidhjet nderkombetare, dhe Albtelecom megjithese zoteron disa lidhje me Fiber Optike me vendet fqinje, nuk ka realizuar ofrimin e ketyre qarqeve me kapacite te larta. Megjithese kapacitetet ekzistuese te Fibrave optike per lidhje nderkomebatere jane vetem \_\_\_\_\_. Teknologjite bejne te mundur vendosjen e terminaleve dhe rritjen e ketyre kapaciteteve.
- mungesa e marrveshjeve te nivelit te sherbimit per afatet dhe cilesine e ofrimit linjave me qera (me shumice dhe me pakice);
  - mungesa e ketyre marrveshjeve dhe kompensimeve finaciare per mos-realizimin e fatave dhe cilesise se rene dakort, i krijojne mundesisne operatorit

Albtelecom te krijojë vonesa të pajustificuara në ofrimin e linjave me qera dhe të mos garantojë cilësi të lartë të tyre.

- mos-ofrimi i linjave të pjeshme me qera me shumicë operatorëve të tjerë;
  - o Aktualisht mund të ketë raste të ofrimit të këtyre qarqeve, por asnjë operator nuk ka dhënë informacion për këto shërbime me shumicë. Ofrimi nga Albtelecom i këtyre qarqeve të pjeshme do të rriste madhësinë e tregut me pakicë të linjabve me qera, pasi edhe vete Albtelecom ka kufizime në mbulimin e territorit me infrastrukture. Ky ofrim do të lejonte operatorë të tjerë të investojnë në infrastrukture në territor ku Albtelecom nuk ka prezencë, çka do të rriste konkurrencën në ofrimin e linjave me qera me pakicë. Njëkohësisht përdorimi i këtyre qarqeve për përdorim në ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të tjerë (të ndryshme nga linjat me qera) komunikimeve elektronike, do të rriste konkurrencën për këto shërbime. Rritja e konkurrencës në tregjet me pakicë të linjave me qera dhe tregjet e shërbimeve dhe rrjeteve të tjerë të komunikimeve elektronike do të rriste mundësitë e zgjedhjes, cilësinë dhe tarifën me të cilën konsumatorin shqiptar.
- mosdhënia e aksesit për linjat me qera me shumicë dhe diskriminimi i operatorëve të telekomunikacioneve (ofruesve të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike);
- mosdhënie e informacionit të mjaftueshëm në lidhje me kapacitetet dhe aftësitë teknike për dhënie të linjave me qera.

Problemet e mësipërme të ofrimit të kapaciteteve transmetuese të dedikuara, kanë krijuar probleme edhe në ofrimin e shërbimeve të tjera të komunikimeve elektronike si Interneti, duke ndikuar negativisht në përfitimet e konsumatorëve për shërbimet e internetit dhe njëkohësisht

Rekomandimet e ERG për zgjidhjen e këtyre problemeve është vendosja e detyrimeve për dhënie akses, mosdiskriminim, transparencë dhe orientim në kosto të tarifave të linjave me qera, masa do të rrisnin mundësinë konkurruese të operatorëve/ofruesve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në tregjet me pakicë të linjave me qera dhe shërbimeve të tjera të komunikimeve elektronike si dhe përfitimet e përdoruesve. Një masë e rëndësishme rregulluese për FNT për linjat me qera është shoqërimi i detyrimit të mosdiskriminimit me detyrimin për dhënie të Garancive apo marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit (service level agreement-SLA) si dhe publikimin e Tregësve Kryesorë të Performancës (Key Performance Indicators -KPI). Nëpërmjet këtyre detyrimeve, sipërmërsi me FNT detyrohet të paguajë kompensim për vonesat apo dështimin e ofrimit të shërbimit sipas afatit kohor dhe cilësisë së rene dakort.

## **VI.2 Përvoja rregullatore dhe rekomandimet e BE për linjat me qera**

Në rekomandimet (dokumentat) kryesore të BE në lidhje me linjat me qera, përmendim:

- COMMISSION DECISION of 24 July 2003 “on the minimum set of leased lines with harmonised characteristics and associated standards referred to in Article 18 of the Universal Service Directive” (2003/548/EC);

- COMMISSION RECOMMENDATION of 21 January 2005 “*on the provision of leased lines in the European Union (Part 1 — Major supply conditions for wholesale leased lines)*” (2005/57/EC)
- COMMISSION RECOMMENDATION of 29 March 2005 “*on the provision of leased lines in the European Union — Part 2 — pricing aspects of wholesale leased lines part circuits*” (2005/268/EC)
- *ERG Common Position on Best Practice in Remedies imposed as a consequence of SMP in the relevant markets for wholesale leased lines (ERG (07) 54 Final080331)*
- **COMMISSION DECISION of 24 July 2003 “*on the minimum set of leased lines with harmonised characteristics and associated standards referred to in Article 18 of the Universal Service Directive*” (2003/548/EC);**

Ky vendim i KE, siguron vazhdimesine e bazes ligjore per setin minimum te linjave me qera, duke identifikuar kete set me karakteristika te harmonizuara dhe standarte shoqeruese, te referuar ne Direktiven Kuader 2002/21/EC dhe Direktiven e Sherbimit Universal, te njejte me perkufizimin e dhene ne Direktiven 92/44/EEC, te dates 5.06.1992, me ndryshimin se referencat e European Telecommunications Standards (ETSS) jane zevendesuar me referenca te European Standards (EN) te rena dakort nga European Telecommunications Standards Institute ne 2001. Ky vendim ka vetem nje nen, i cili referon setin minimum te linjave me qera me karakteristika te harmonizuara dhe standarte shoqeruese ne Aneksin e ketij Vendimi, e cila eshte reflektuar si Aneks 2 i ketij dokumenti Analize.

- **COMMISSION RECOMMENDATION of 21 January 2005 “*on the provision of leased lines in the European Union (Part 1 — Major supply conditions for wholesale leased lines)*” (2005/57/EC)**

Ky dokument i KE, rekomandon rregullatoret qe ne vendosjne e detyrimeve per operaoret me FNT ne ofrimin e linjave me qera, te sigurojne qe kontratat perfshijne Marrveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement\_SLA), e cila te mbuloje te gjitha aspektet e rendesishem te ofrimit te linjave me qera me shumice si kerkesa, porositjen, migrimin, dorezimin, cilesine, raportimin, koha e rregullimit te defekteve, dhe kompensime finaciare ne rast te mo- realizimit te treguesve te rene dakort. Ky dokument rekomandon rregullatoret qe te sigurojne qe afatet e ofrimit te linjave me qera me shumice te jene me shkurtera se afatet e praktikave me te mira te ofrimit te linjave me qera me pakice ne vendet e BE. Rekomandimi, ne Aneks percakton dhe praktiken me te mire per afatet e sigurimit te linjave me qera me pakice, 64kbit/s, 2Mbit/s dhe 34 Mbit/s, si me poshte:

1. per linjat me qera **64 kbit/s: 18** dite kalendarike
2. per linjat me qera te pastrukturuara (unstructured) **2 Mbit/s: 30** dite kalendarike
3. per linjat me qera te strukturuara (structured) **2 Mbit/s: 33** dite kalendarike
4. per linjat me qera te pastrukturuara (unstructured) **34 Mbit/s: 52** dite kalendarike

Praktika me mire eshte percaktuar si afati i trete me i vogel i ofrimit te linjes me qera nga vendet e BE. Afati i ofrimit eshte koha e sigurimit te linjes me qera nga operatori, nga data kur eshte bere nje kerkesa e precize (firm request) nga perdoruesi.

- **COMMISSION RECOMMENDATION of 29 March 2005 “on the provision of leased lines in the European Union — Part 2 — pricing aspects of wholesale leased lines part circuits” (2005/268/EC)**

Ky dokument i KE, rekomandon rregullatoret qe ne rastet e vendosjes se detyrimit per kontroll te tarifave dhe orientim ne kosto te per linjat me qera me shumice (qarqet e pjeshme), te sigurojne se tarifat jane te tarifat e ofrimit te ketyre qareve te perfshijne vetem kostot e elementeve te rrjetit te perdorur dhe sherbimeve te krkuara, duke perfshire nje norme fitimi te arsyeshme. Gjithashtu rregullatoret duhet te sigurojne aplikimin e cmimeve tavan per qarqet e pjeshme te linjave me qera me shumice, te dhena ne Aneks 1 te rekomandimit, dhe te lejojne devijime vetem ne rastet kur evidetohet nga analiza e kostove (te aprovuara nga rregullatori) se keto cmime rekomanduese do te rezultojne ne nje nivel cmimi me te ulet se kostoja e elementeve te rrjetit te perdorur dhe sherbimeve te krkuara, duke perfshire nje norme fitimi te arsyeshme. Cmimet tavan per keto qarqe te pjeshme me qera per kapacitete dhe distanca te ndryshme, jane si me poshte:

(EUR)

Capacity	Ceiling for the sum of the monthly price and 1/24 of the one-off connection price for a circuit length of up to 2 km	Ceiling for the sum of the monthly price and 1/24 of the one-off connection price for a circuit length of up to 5 km	Ceiling for the sum of the monthly price and 1/24 of the one-off connection price for a circuit length of up to 15 km	Ceiling for the sum of the monthly price and 1/24 of the one-off connection price for a circuit length of up to 50 km	Ceiling for the One-off connection price
64 kbit/s	61	78	82	99	542
2 Mbit/s	186	248	333	539	1 112
34 Mbit/s	892	963	1 597	2 539	2 831
155 Mbit/s	1 206	1 332	1 991	4 144	3 144

Gjatesi e linjes, perkufizohet distanca radiale midis dy vendodhjeve te pikave fundore te linjes, d.m.th nga pika e interkoneksionit deri tek godina e klientit (klienti i operatorit tjetër).

- **ERG Common Position on Best Practice in Remedies imposed as a consequence of SMP in the relevant markets for wholesale leased lines (ERG (07) 54 Final080331)**

Ne kete dokument, ERG trajton problemet qe mund te shfaqen ne ofrimin me shumice te linjave me qera dhe jep rekomandime per zgjidhjen e tyre.

Nder keto masa rregulluese te rekomanduara per linjat me qera me shumice mund te permendim:

- Vendosjen e detyrimit per te dhene akses, per te siguruar ofrimin me shumice te linjave me qera;
- Vendosjen e detyrimit te mos-diskriminimit, duke specifikuar:
  - o detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin me shumice dhe me pakice te linjave me qera;
  - o detyrimin per te bere te disponueshem inputet e nevojshme me shumice per produktet/ sherbimet e reja apo te permiresuara me pakice;

Keto detyrime ndihmojnë në eliminimin e problemeve të diskriminimit midis operatorëve të ndryshme apo midis operatorëve të tjerë dhe klientëve/pjesëve të biznesit të operatorit të FNT.

- Detyrimi për publikimin e Oferte Reference për linjat me qera, e cila të përmbajë të gjithë termat dhe kushtet e aksesit në rrjet, përfshirë ato të shërbimeve ndihmese,<sup>16</sup> termat dhe kushtet kryesore kontraktuale, si dhe detyrimin për përditesimin e ofertes. Ky detyrim ndihmon në realizimin e objektivit të transparencës së termave dhe kushteve të aksesit.
- Detyrimi për të plotësuar të gjitha kërkesat e arsyeshme për të dhënë akses;
- Detyrime në lidhje me tarifën si orientimi në kosto efektive, apo tarifimin e ngjashëm të shërbimeve, detyrimi për të tarifuar rasyeshme për infrastrukturën e re (duke marrë në konsideratë të gjithë jetën ekonomike të saj);
- Detyrimi për të ofruar linja me qera ethernet krahas linjave tradicionale me qera;
- Detyrimi për të ofruar marrveshje të Nivelit të Shërbimit (service level agreement-SLA)
- Detyrimi për të paguar kompensim për vonesat apo deshtimin e ofrimit të shërbimit sipas afateve kohore dhe cilësive të rene dakort.
- Detyrimi për të lejuar proceset e migrimit në rrjet, midis klientëve të ndryshëm me shumicë apo midis produkteve të ndryshme me shumicë për të njëjtin klient. Keto procese janë të nevojshme për transferimin e klientëve fundorë apo ndërrimin e shërbimeve të tyre, dhe nuk duhet të imponohen kosto të pajustificueshme nga operatori me FNT tek operatorët e tjerë (blerës me shumicë).

### **VI.3 Masat Rregulluese për FNT të Albtelecom: linjat me qera me shumicë dhe seti minimum i linjave me qera me pakicë**

Në bazë të parashikimeve të ligjit, neni 34, *Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ajo vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji.*

Në vendosjen e detyrimeve, AKEP mban parasysh objektivat rregullatore dhe detyrimet ndaj operatorëve me FNT duhet të jenë proporcionale me masën e problemit dhe të mos jenë barre e tepër për operatorin.

Bazuar në evidentimin e problemeve që ekzistojnë dhe që mund të lindin në ofrimin e linjave me qera me pakicë, seti minimum, dhe të linjave me qera me shumicë, AKEP gjykon se masat e nevojshme në nivelin me shumicë të ofrimit të linjave me qera nga Albtelecom, me referencë në parashikimet e Ligjit 9918, janë:

1. Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39)
2. Detyrimi i transparencës (Neni 40)
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive (Neni 41)
4. Detyrimi për akses dhe përdorim të përbashkët të faciliteteve të rrjetit (Neni 42)
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive (Neni 45)

Detyrimet mesipërme midis të tjerave përfshijnë:

---

<sup>16</sup> Bashkevendosje, ajri I kodncionuar, energjia, qarqet e brendshme, multipleksimi i qarqeve, qarqet e interkoneksionit etj

- Publikimin e ofertes reference te aksesit ne rrjetin Albtelecom per linjat me qera me shumice. Per kete pike Albtelecom do te duhet te zbatoje procedurat dhe rregullat per publikimin dhe permbajtjen e oferte refernce jane parashikuar ne Ligj dhe ne rregulloren e Akses dhe Interkoneksionit (e cila pritet te amendohet nga AKEP). Ofreta reference duhet te permbaje te gjithë termat dhe kushtet e aksesit ne rrjet, perfshire ato te sherbimeve ndihmese,<sup>17</sup> termat dhe kushtet kryesore kontraktuale. Kjo oferte reference per linjat me qera do te jete oferta e pare e ketij lloji per Albtelecom, por e dyta pas ofertes refernce te interkoneksionit.
- Albtelecom duhet te mos diskriminoje midis operatoreve te ndryshem dhe midis operatoreve te tjere dhe klienteve, filialeve te veta;
  - Bazuar ne kete detyrim, Albeelcom do te duhet te reduktoje tarifat e linjave me qera nderkombetare per kompanite e telekomunikacioneve, ne nivele te pakten te njejte me klientet e tij me pakice (shiko me poshte)
  - detyrimin per publikimin e Treguesve Kryesore te Performances (Key Performance Indicators -KPI) per ofrimin me shumice dhe me pakice te linjave me qera. Nje nder keta tregues do te jete koha e sigurimit te linjes me qera, per te cilat do te zbatohet rekomandimi i KE (shiko me poshte);
  - detyrimin per te bere te disponueshem inputet e nevojshme me shumice per produktet/ sherbimet e reja apo te permiresuara me pakice;
  - Detyrimi per te ofruar marrveshje te Nivelit te Sherbimit (service level agreement-SLA)
  - Detyrimi per te paguar kompensim per vonesat apo deshtimin e ofrimit te sherbimit sipas afateve kohore dhe cilesise se rene dakort.
- Albtelecom do te duhet te jape akses per linja me qera me shumice ne rrjetin e vet, linja te cilat perfshijne:
  - Linja me qera me shumice: linja te njehta si linjat e ofruara klienteve fundore, me ndryshimin se bleresi eshet nje kompani telekomunikacioni apo sipermarres i rrjeteve dhe/ose sherbimeve te komunikimeve elektronike (rregjistruar ne AKEP);
  - Qarqe te pjesshme me qera (Leased line partial Circuits): qarqe transmetimi qe lidhin nje klient fundor te operatorit tjetër me piken e interkoneksionit te Albtelecom me operatorin tjetër si dhe qarqet e transmetimit te ofruar nga Albtelecom operatoreve te tjere per tu perdorur ne interkoneksionin e ndermjetem apo ne anen e klientit.
  - **Ofrimin me shumice te linjave me qera ethernet;**
  - Kapaciteti i linjave te dhena nga Albtelecom do te jete ne varesi te kerkeses se bleresit, duke perfshire dhe qarqet 34 mbit/s dhe 155 mbit/s. Rastet e pamundesise teknike te ofrimit nga Albtelecom, do et duhet te justifikohen me shpjegime te plota, bazuar ne rregullat dhe proceduar e kuadrit ligjor dhe rregullator (Rregullorja e Akses dhe Interkoneksion);

---

<sup>17</sup> Bashkevendosje, ajri I kodncionuar, energjia, qarqet e brendshme, multipleksimi i qarqeve, qarqet e interkoneksionit etj

## **Afatet e ofrimit te linjave me qera**

AKEP gjykon se nder detyrimet per Albtelecom, per ofrimin e Marrveshje te Nivelit te Sherbimit (Service Level Agreement\_SLA), te perfshije afatet maksimale te sigurimit te linjave me qera, me pakice dhe me shumice, ne perputhje me rekomandimin, COMMISSION RECOMMENDATION of 21 January 2005 “on the provision of leased lines in the European Union (Part 1 — Major supply conditions for wholesale leased lines)” (2005/57/EC):

1. per linjat me qera **64 kbit/s: 18** dite kalendarike
2. per linjat me qera te pastrukturuara (unstructured) **2 Mbit/s: 30** dite kalendarike
3. per linjat me qera te strukturuara (structured) **2 Mbit/s: 33** dite kalendarike
4. per linjat me qera te pastrukturuara (unstructured) **34 Mbit/s: 52** dite kalendarike

Afati i ofrimit eshte koha e sigurimit te linjes me qera nga operatori, nga data kur eshte bere nje kerkese e precize (firm request) nga perdoruesi.

## **Kontrolli i tarifave te linjave me qera dhe orientimi ne kosto**

Nje nder problemet kryesore qe ekziston ne ofrimin me pakice dhe me shumice te linjave me qera nga Albtelecom, eshte tarifimi i linjave me qera dhe nivelet shume me te larta ose shume me te uleta se tarifat mesatare ne vendet e BE. Ligji 9918, nenin 5 te tij, percakton midis te tjerave se:

*AKEP-i nxit konkurrencen efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera:*  
*a) për t’u krijuar mundësinë çdo kategorie përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe përdoruesit me nevoja të veçanta, që kundrejt tarifave në çdo rast jo më të larta se tarifat mesatare të vendeve të BE-së, mbi bazën e përzgjedhjes të përfitojnë maksimalisht shërbime alternative, cilësore dhe në përputhje me standardet e miratuara nga AKEP-i;*

Per shkak te problemeve te evidentuara ne tarifimin e linjave me qera me pakice, seti minimum, dhe me shumice te Albtelecom, si dhe per shkak te pamjaftueshmërisë se masave te tjera rregulluese per te eliminuar problemet e tarifave te linjave me qera, AKEP gjykon se tarifat e linjave me qera me shumice dhe me pakice te Albtelecom duhet te jene subjekt kontrolli, dhe ne zbatim me nenin 5/a te ligjit, keto tarifa nuk duhet te jene me te medha se niveli mesatar i vendeve te BE. Per metoden e rregullimit te tarifave, AKEP gjykon qe fillimisht, per nje periudhe 1 vjecare te aplikojë metoden e cmimit tavan apo maksimal, duke perdorur si reference nivelin mesatar te vendeve te BE, apo praktiken me te mire te vendeve te BE. Keto metoda jane te parashikuara ne nenin 57, pika 1/a dhe 2/a dhe 2/b.

Per periudhe afatgjate, AKEP gjykon se tariaft e orientuara ne koston efiçente te ofrimit te linjave me qera, eshte metoda me mire e tarifimit, dhe metoda LRAIC e rekomanduar nga KE, eshte metoda me e mire per nxitjen e konkurrences efektive ne ofrimin e linjave me qera dhe shërbimeve et tjere ta komunikimeve elektronike. AKEP ka kontraktuar nje kompani konsulente nderkombetare per percaktimin e kostove te shërbimeve te Albtelecom, me modelin BULRAIC(Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost), dhe nder outputet e

modelit do të jenë edhe kostoja e linjave me qera dhe rekomandime për tarifimin e tyre. Detyrimi i orientimit në kosto të tarifaev të linjave me qera është në përputhje me nenin 44 (seti minimim) dhe nenin 45 të Ligjit, si edhe nenin 59/2 për përdorimin nga AKEP të metodave të llogaritjes së kostos efektive të pavaruara nga operatori.

AKEP pas marrjes së rezultateve dhe rekomandimeve të këtij projekti (fillimi i vitit 2010), gjykon se do të jetë nevojshme të zhvillojë një konsultim publik për marrjen e një vendimi për rregullimin e tarifave të linjave me qera.

Për linjat me qera me pakice dhe me shumice (përfshirë qarqet e pjeshme të linjave me qera të dhëna operatoreve për interkoneksion) të cilat kanë tarifa me të ulëta se mesatarja e vendeve të BE, AKEP gjykon që këto tarifa të mos ndryshojnë deri në justifikimin e kostos së tyre nëpërmjet modelit BULRAIC, për klientet me të cilët Albtelecom ka lidhur tashmë një kontratë. Për klientet e rinj dhe me mbarimin e afatit të kontratave, Albtelecom mund të lejohet të rrisë tarifën deri në nivelin mesatar të vendeve të BE, pas marrjes së aprovimit nga AKEP. AKEP gjykon se rritja e tarifave do të jetë e nevojshme, për shkak se tarifimi nën-kosto ka efekte negative si edhe tarifimi mbi kosto. Një ndër efektet negative të tarifimit nën-kosto të shërbimeve të aksesit, është reduktimi i stimujve për të investuar në infrastrukturë, si dhe stimulimi i investimeve jo-eficiente.

Për shkak se informacioni i tarifave të linjave me qera me shumice (përfshirë qarqet e pjeshme të linjave me qera) në nivel BE, nuk është i plotë, AKEP gjykon të aplikojë metodën retail minus, domethënë rregullimin e tarifave me shumice duke u bazuar në tarifën me pakice të shërbimit, minus një përqindje, e cila vlerësohet të jetë e arsyeshme dhe që normalisht mbulon koston e marketingut për shitjen me pakice nga operatori incumbent. Vlera e zbritjes e përdorur normalisht është 20%. AKEP propozon të aplikojë këto metode për linjat me qera ndërkombëtare të Albtelecom, të ofruara sipërmarresve të komunikimeve elektronike (kompanive të telekomunikacionit të referuara nga Albtelecom), si edhe për qarqet kombëtare të cilat kanë tarifa mbi nivelin mesatar të BE, dhe që do të reduktohen deri në nivelin mesatar të BE.

Tarifat e linjave ndërkombëtare me pakice do të kenë tarifa maksimale të barabarta me mesataren e vendeve të BE, ndërsa të njëjtat linja por që iu ofrohen sipërmarresve ofruar të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike do të kenë tarifë 20% me të ulëta (pjesa që i paguhet Albtelecom).

Si tarifa referencë për tarifën mesatare të linjave me qera me pakice të vendeve të BE, do të referohemi të dhënat e publikuara në dokumentat:

*European Commission: Progress Report on the Single European Electronic Communications Market 2008 (14th Implementation Report)*

*Report on Telecoms Price Developments from 1998 to 2007. Prepared by Teligen December 2007, for European Commission, Directorate General for Information Society*

Dokumenti i parë paraqet të dhëna për vitet 2007-2008 vetëm për linjat me qera kombëtare, 2 dhe 34 Mbit/s, për distancat 2 km dhe 200 km.

Dokumenti i dytë paraqet të dhëna historike 1998-2007 për qarqet kombëtare 64 kbit/s, 2 Mbit/s, 34 Mbit/s dhe 155 Mbit/s, për distancat 2 km, 50 km dhe 200 km, si dhe për qarqet ndërkombëtare 64 kbit/s, 2 Mbit/s, 34 Mbit/s dhe 155 Mbit/s, drejt vendeve fqinje dhe të largëta të BE, SHBA dhe Japoni. Të dhënat e tarifave për qarqet ndërkombëtare janë për çdo shtet, mesatare e BE 27, dhe mesatare e ponderuar e BE. Informacioni për qarqet 34 Mbit/s

dhe 155 Mbit/s është me I kufizuar se për qarqet 64 kbit/s dhe 2mbit/s, dhe vecanerisht për destinacionet të largëta.

Megjithatë dokumenti I dytë, përmban informacion me të plotë për tarifën e linjave me qerë me pakicë, kombëtare dhe ndërkombëtare, këtu të dhëna do të përdoren për vendosjen e tarifave maksimale të tarifave të Albtelecom për qarqet kombëtare dhe ndërkombëtare. Për qarqet ndërkombëtare do të përdoret vlera e tarifës mesatare të ponderuar.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerat e tarifave aktuale të Albtelecom, në Euro, vlerat e tarifave mesatare të BE, vlera e propozuar për tarifën maksimale të Albtelecom me pakicë dhe me shumicë.

**Tabela VI.1 Propozimi për rregullimin e Tarifave me pakicë dhe me shumicë të linjave me qerë kombëtare të Albtelecom**

Kombëtare		Albtelecom	EU 27 2007/8	Tarifat e rregulluara		Ndryshimi	
Distanca	Kapaciteti			Me pakicë	Me shumicë	Me pakicë	Me shumicë
2 km	64 Kbit/s	145	166	166	133	14.27%	-8.58%
	2 Mbit/s	203	587	587	470	188.64%	130.91%
50 km	64 Kbit/s	218	340	340	272	56.04%	24.83%
	2 Mbit/s	436	1,500	1,500	1,200	244.20%	175.36%
200 km	64 Kbit/s	581	460	460	368	-20.83%	-36.67%
	2 Mbit/s	872	2,591	2,591	2,073	197.27%	137.82%
2 km	34 Mbit/s		2,500		2,000		
	155 Mbit/s		5,000		4,000		
50 km	34 Mbit/s		8,000		6,400		
	155 Mbit/s		17,000		13,600		
200 km	34 Mbit/s		16,000		12,800		
	155 Mbit/s		30,000		24,000		

**Tabela VI.2 Propozimi për rregullimin e Tarifave me pakicë dhe me shumicë të linjave me qerë Nderkombëtare të Albtelecom**

Nderkombëtare		Albtelecom	EU 27 2007/8	Tarifat e rregulluara		Ndryshimi	
Vend Fqinj	Kapaciteti			Me pakicë	Me shumicë	Me pakicë	Me shumicë
Vend Fqinj	64 Kbit/s	750	736	736	589	-1.87%	-56.64%
		1,358					
	2 Mbit/s	9,760	8,906	8,906	7,125	-8.75%	-54.60%
		15,693					
Vend I larget	64 Kbit/s		1,072	1,072	858		
	2 Mbit/s		12,514	12,514	10,011		

BE	34 Mbit/s		100,203	100,203	80,162		
	155 Mbit/s		204,066	204,066	163,253		
SHBA	64 Kbit/s		1,253	1,253	1,002		
	2 Mbit/s		14,128	14,128	11,302		
	34 Mbit/s		126,897	126,897	101,518		
	155 Mbit/s		230,161	230,161	184,129		
Japoni	64 Kbit/s		2,562	2,562	2,050		
	2 Mbit/s		27,915	27,915	22,332		
	34 Mbit/s		360,607	360,607	288,486		
	155 Mbit/s		385,585	385,585	308,468		

### **Standartet per linjat me qera me pakice, seti minimum**

Nje detyrim specifik per linjat me qera me pakice eshte parashikuar ne nenin 44 te Ligjit, detyrimi për ofrimin e një grupi minimal të linjave me qira, në përputhje me parimet e mosdiskriminimit, të orientimit në kosto dhe transparencës, duke pasur parasysh dokumentet dhe praktikatat rregullatore ndërkombëtare përkatëse.

Ne lidhje me standartet e grupit minimal (apo setit minimum) te linjave me qera AKEP propozon qe Albtelecom ne ofrimin e linjave me qera me pakice, deri ne dhe perfshire 2 Mbit/s, te aplikoj standartet e rekomanduara nga COMMISSION DECISION of 24 July 2003 “on the minimum set of leased lines with harmonised characteristics and associated standards referred to in Article 18 of the Universal Service Directive” (2003/548/EC). Sic u theksua me siper, referon setin minimum te linjave me qera me karakteristika te harmonizuara dhe standarte shoqeruese ne Aneksin e ketij Vendimi, e cila eshte reflektuar si Aneks 2 i ketij dokumenti Analize.

***Pyetje:***

- 11. Ne pervojen tuaj si bleres i linajve me qera nga Altelecom, me shumice apo me pakice, a keni pasur probleme me vonesat apo aspkete te tjera te sherbimit?***
- 12. A ka operatore ne Shqiperi qe mund te ofrojne kapacitete transmetuese me qera 34 Mbit/s, 155 mbit/s dhe nese po cfare tarifash aplikohen?***
- 13. A mendoni se detyriemet e propozuar te AKERP per FNT te Altelecom jane te arsyeshme/te mjaftueshme per te eliminuar problemet e tregut per linjat me qera?***
- 14. A eshte i arsyeshem detyrimi i propozuar per Altelecom per te dhene akses per kapacitete transmetuese me qera 34 Mbit/s, 155 mbit/s?***
- 15. Cfare mendoni per propozimin e AKERP per rregullimin e tarifave te linjave me qera te Altelecom?***
- 16. A duhet te rriten tarifat e linjave me qera kombetare te Altelecom ne nivel mesatare te BE, fillimisht vetem per klientet e rinj dhe ata te cilet u perfundojne kontratat?***
- 17. Cfare masash te tjera rregullatore mendoni se jane te nevojshme per linjat me qera?***

## ANEKS 1. TARIFAT E ALBTELECOM PER LINJAT ME QERA

<b>1.Linje ne Dispozicion ne rrjetin urban</b>	4.000 Lek/muaj
<b>2.Sistem F.O ne rrjetin urban</b>	60.000 lek/muaj
<i>Ne kete rast nuk do te aplikohet tarife instalimi fikse</i>	

### 3.Qarqe ANALOGE

#### Tarifa instalimit

Emertimi	Njesia Matese	Tarifa
Tarifa instalimit Qark Kombetar	LEKE	20.000
Tarifa instalimit Qark Nderkombetar	USD	700

#### Tarifa pajtimit mujor per qarqe analoge KOMBETARE 4- filleshe

Emertimi	Njesia Matese	deri ne 25 km	25-50 km	50-100 km	Mbi 100 km
Tarifa qark Pik-Pik	LEKE/MUAJ	34.500	67.200	73.000	96.000

#### Tarifa pajtimit mujor per qarqe analoge NDERKOMBETARE 4- filleshe

Emertimi	Njesia Matese	Fqinje	Europa I	Europa II	Ekstraerupe
Tarifa qarqe analoge	USD/MUAJ	765	850	1.250	1.500

### 4. Qarqe dixhitale KOMBETARE me qera

4. Qarqe dixhitale KOMBETARE me qera		
Shpejtesia e transmetimit	Tarifa pajtimit mujor	Tarifa e instalimit
	LEK/ MUAJ	LEK

	deri ne 25 Km	
64 Kbit/s	20.000	20.000
2 Mbit/s	28000	
	25-50 Km	
64 Kbit/s	30.000	30.000
2 Mbit/s	60.000	
	50-100 Km	
64 Kbit/s	40.000	50.000
2 Mbit/s	100.000	
	mbi 100 Km	
64 Kbit/s	80.000	60.000
2 Mbit/s	120.000	
	<i>Shenim: Tarifat jane pa TVSH</i>	

<b>5. Qarqet digitale NDERKOMBETARE me qera (per transmetim te dhenash)</b>		
		<b>Tarifa Pajtimimit Mujor</b>
<b>Shpejtesia e transmetimit</b>	<b>Tarifa instalimit</b>	
	<b>EURO</b>	<b>EURO/MUAJ</b>
64 Kbit/s	600	750
2 Mbit/s	1.740	9.760
<i>Shenim: Tarifa perfshin segmentin nderkombetar shqiptar, qarkun kombetar dhe qarkun lokal</i>		
<i>Tarifa e instalimit aplikohet vetem nje here pavaresisht nga kohezgjatja e kontrates</i>		

<b>6. Qarqet digitale me qera NDERKOMBETARE (Per Kompani Telekomunikacioni)</b>			
			<b>Tarifa pajtimimit mujor (USD/MUAJ)</b>
<b>Nr.</b>	<b>Shpejtesia e transmetimit</b>	<b>Tarifa instalimit</b>	
		<b>USD</b>	<b>Fqinje</b>
1	64 Kbit/s	960	2.015
2	2 Mbit/s	3.130	23.285
<i>Shenim: Tarifa perfshin segmentin nderkombetar shqiptar, qarkun kombetar dhe qarkun lokal</i>			
<i>Tarifa e instalimit aplikohet vetem nje here pavaresisht nga kohezgjatja e kontrates</i>			

<i>Tarifa e instalimit aplikohet vetem nje here pavaresisht nga kohezgjatja e kontrates</i>	
---	--

<i>Ne instalimin e ketij qarku perfshihet qarku lokal dhe kombetar ne dispozicion, i cili jepet pa pagese</i>
---

**ANEKS 2. LISTA E STANDARTEVE DHE/OSE SPECIFIKIMEVE PER SETIN MINIMUM  
TE LINJAVE ME QERA (2003/548/EC).**

**Identification of the minimum set of leased lines with harmonised characteristics and associated standards**

ANALOGUE LEASED LINES

Leased line type	Reference	Notes
Ordinary quality voice bandwidth <sup>(a)</sup>	— 2 wire: ETSI EN 300 448 or — 4 wire: ETSI EN 300 451	Connection characteristics and network interface presentation
Special quality voice bandwidth <sup>(b)</sup>	— 2 wire: ETSI EN 300 449 or — 4 wire: ETSI EN 300 452	Connection characteristics and network interface presentation

<sup>(a)</sup> Leased lines meeting the requirements of ETS 300 448 (2 wire) or ETS 300 451 (4 wire) are deemed to comply with the requirements for this type of leased line.

<sup>(b)</sup> Leased lines meeting the requirements of ETS 300 449 (2 wire) or ETS 300 452 (4 wire) are deemed to comply with the requirements for this type of leased line.

DIGITAL LEASED LINES

Leased line type	Reference	Notes
64 kbit/s <sup>(c)</sup>	— ETSI EN 300 288 — ETSI EN 300 289	Network interface presentation Connection characteristics
2 048 kbit/s — E1 (unstructured) <sup>(d)</sup>	— ETSI EN 300 418 — ETSI EN 300 247	Network interface presentation Connection characteristics
2 048 kbit/s — E1 (structured) <sup>(e)</sup>	— ETSI EN 300 418 — ETSI EN 300 419	Network interface presentation Connection characteristics

<sup>(c)</sup> Leased lines meeting the requirements of ETS 300 288, ETS 300 288/A1 and ETS 300 289 are deemed to comply with the requirements for this type of leased line.

<sup>(d)</sup> Leased lines meeting the requirements of ETS 300 418, ETS 300 247 and ETS 300 247/A1 are deemed to comply with the requirements for this type of leased line.

<sup>(e)</sup> Leased lines meeting the requirements of ETS 300 418 and ETS 300 419 are deemed to comply with the requirements for this type of leased line.

### ANEKS 3. LISTA E PYETJEVE PER KONULTIM PUBLIK

Me poshte eshte nje permbledhje e pyetjeve per te cilat AKEP eshte i interesuar te marre komente nga palet e interesuara. Palet mund te japin komente edhe per pjese te tjera te dokumentit te analizes dhe perfundimeve te AKEP.

- 1. A mendoni se linjat me qera te kapaciteve 64 Kbit/s deri ne 2 Mbit/s jane pjese e te njetit treg perkates?*
- 2. A mendoni se linjat me qera te kapaciteve mbi 2 Mbit/s jane pjese e tregjeve perkates te ndryshem nag seti minimum i linjave me qera?*
- 3. Cili eshte opinionioni juaj per linjat me qera nderkombetare dhe perfshirjen e tyre ne te njetin treg perkates me linajt kombetare?*
- 4. A mendoni se AKEP ka percaktuar drejte tregun me pakice te linjave me qera, setin minimum?*
- 5. A mendoni se Albtelecom ploteson kriteret per FNT ne tregun me pakice te linjave me qera?*
- 6. A mendosi se eshte e nevojshme te percaktohen dy tregje me shumice te linjave me qera: segmente terminuese dhe segmente trunk te tyre?*
- 7. Cili eshte opinionioni juaj per tregjet perkates me shumic ete linjave me qera te perkufizuar nga AKEP?*
- 8. Cfare opinionioni keni per nivelin e tarifave te linjave me qerame shumice te Albtelecom?*
- 9. Cfare ndikimi kane operatoret e tjere(pervec Albtelecom) ne ofrimin e linjave me qera me shumice dhe me pakice: ne terma te cmimeve, kapaciteteve dhe cilesise se ofruar?*
- 10. A mendoni se Albtelecom permbush kriteret per FNT ne tregjet me shumice te linjave me qera?*
- 11. Ne pervojen tuaj si bleres i linjave me qera nga Albtelecom, me shumice apo me pakice, a keni pasur probleme me vonesat apo aspkete te tjera te sherbimit?*
- 12. A ka operatore ne Shqiperi qe mund te ofrojne kapacitete transmetuese me qera 34 Mbit/s, 155 mbit/s dhe nese po cfare tarifash aplikohen?*
- 13. A mendoni se detyriemet e propozuar te AKEP per FNT te Albtelecom jane te arsyeshme/te mjaftueshme per te eliminuar problemet e tregut per linjat me qera?*
- 14. A eshte i arsyeshem detyrimi i propozuar per Albtelecom per te dhene akses per kapacitete transmetuese me qera 34 Mbit/s, 155 mbit/s?*
- 15. Cfare mendoni per propozimin e AKERP per rregullimin e tarifave te linjave me qera te Albtelecom?*

- 16. A duhet te rriten tarifat e linjave me qera kombetare te Albtelecom ne nivel mesatare te BE, fillimisht vetem per klientet e rinj dhe ata te cilet u perfundojne kontratat?*
- 17. Cfare masash te tjera rregullatore mendoni se jane te nevojshme per linjat me qera?*